

Nöppöer Feminizem

qika

**NËPËR
FEMINIZËM**

2024

Ky botim u realizua nga Qendra për Informim, Kritikë dhe
Aksion - QIKA.

Librin mund ta gjeni edhe online në www.qika.org.

qika

PAK FJALË MBI BOTIMIN

Është e qartë se puna nuk përkthehet vetëm në vlerë monetare, por përmes këtij aktiviteti përsëritës e rraskapitës, makina e sistemit lakon trupa, amortizon vullnete, okupon hapësira dhe grabit momente. Neoliberalizmi ka përthithur kohën dhe hapësirën duke na i zëvendësuar me kënaqësi të momentit, qef të aty për atyshëm. Puna eksploatuese, duke na prekur jetën personale, mënyrën si e mendojmë dhe e organizojmë atë, fikson strukturën dhe raportet e pushtetit që ajo riprodhon vazhdimisht, për hirë të vetës, deri në pafundësi po të jetë e mundur.

Një shoqëri kaq e kushtëzuar nuk ka si të jetojë në mirëqenie, liri e barazi, pa i përmbysur marrëdhëniet dominuese. Gratë vazhdojnë të mbajnë peshën e punëve të papaguara në shtëpi, përderisa përballen me pabarazi në tregun e punës. Kërkesa për barazi në punë është thirrje për transformim të strukturave që mbajnë gjallë shtypjen.

Ky botim ngre një pyetje thelbësore: Si mund ta organizojmë punën në mënyrë që të çlirojë gratë? Në ç'masë është kjo e mundur? A mjafton reforma apo duhet një destabilizim më i gjerë?

Përzgjedhja e artikujve nuk ishte e rastësishme, por fryt i një reflektimi të gjatë mbi atë çfarë ka frymëzuar më shumë përpjekjen tonë të përditshme për barazi e drejtësi. Çdo faqe është hapësirë ku idetë dhe mendimet përplasen për të krijuar mundësi të reja për organizim dhe ndryshim.

Në një botë që ende nënvlerëson punën e padukshme të grave dhe shfrytëzimin e tyre si shtyllë të sistemit kapitalist, ky botim sjell një qasje kritike mbi këto çështje. Artikujt dhe intervistat e përzgjedhura na ftojnë të rimendojmë themelet e një sistemi që riprodhon pabarazi. Qasja në këto ide, e bërë e mundur nga përkthimet e aktivisteve femi-

-niste, është një përpjekje për të hapur rrugë drejt ndryshimeve më të mëdha - përtej kufijve gjeografikë dhe shoqërorë.

Në “Nëpër Feminizëm II,” çdo lexues do të gjejë jo vetëm mendime, por edhe ide për organizim dhe veprim, kështu botimi është thirrje për reflektim mbi sfidat dhe idealet që kanë formësuar lëvizjen feministe ndër vite.

Çdo grua është grua punëtore!

Ju ftojmë ta lexoni me mendje të hapur dhe zemër të gatshme për ndryshim.

Leonida Molliqaj

Drejtoreshë Ekzekutive dhe Kryeredaktore në QIKA

PËRMBAJTJA

1. Çdo grua është grua punëtore -----	1
2. Rimendimi i gjinisë, racës dhe klasës nga koncepti i punës -----	11
3. Puna emocionale që nuk paguhet por pritet nga gratë -----	31
4. Punëve të shtëpisë po ju vjen fundi: një perspektivë e klasës punëtore -----	39
5. Pse burrat nuk e shfrytëzojnë pushimin e atësisë? -----	63
6. Zonja shefe ma sjell një kafë -----	71
7. Pse gratë janë më të rraskapitura se burrat? -----	76
8. Nuk është punë dashurie -----	84

1

QDO GRUA
, ËSHTË GRUA
PUNËTORE

Në vitin 1972, feministet nga Italia, Anglia dhe Shtetet e Bashkuara, u mbledhën në Padova të Italisë për një Konferencë dy ditore. Të lidhura me të majtën jashtëparlamentare, luftërat anticolonialiste dhe alternativat e partisë komuniste, këto aktiviste hartuan një deklaratë për veprim: "Deklarata e Kolektivit Ndërkombëtar Feminist", e cila hedhë poshtë ndarjen e punës së papaguar në shtëpi dhe punës së paguar në fabrika, duke i shpallur punët e shtëpisë si terren kritik në luftën e klasave kundër kapitalizmit.

Silvia Federici, emigrante italiane që jeton në New York, mori pjesë në këtë konferencë ku më pas u kthye në New York për të themeluar Komitetin e Pagave të New York-ut mbi punët e shtëpisë. Në vitet pasuese, ky komitet mori përmasa të gjera, duke u shpërndarë në qytete të ndryshme të SHBA-së. Në secilin rast, këto grupe organizoheshin në mënyrë autonome, ndaras nga punëtorët burra që punonin me pagesë. Siç thotë edhe "Teza mbi pagat për punët e shtëpisë" (1974), "Autonomia prej burrave është autonomi prej kapitalit, që e përdorë fuqinë e tyre për të na disiplinuar".

Në New York, Komiteti i Pagave për Punët e Shtëpisë përbëhej nga jo më shumë se njëzetë gra, të cilat mbanin lidhje të ngushta me Komitetin Italian Triveneto dhe Kolektivin "Fuqia e Grave" në Londër. Siç e kujton Federici, pati qarkullim të lartë të njerëzve gjatë viteve të para, ndërsa anëtarët diskutonin natyrën paradoksale të kërkesës për pagë: a ishte ky kompensim për punët e shtëpisë dhe, nëse po, a ishte një reformin i thjeshtë që përfshinte më tej punën e grave në sistemin kapitalist – apo ishte kërkesa për pagë një përmbysje e punëve të shtëpisë, duke i zhvendosur rolet dhe identitetet sociale të grave?

Këto ishin pyetjet qendrore në debatet për punët e shtëpisë gjatë viteve 1960 deri në vitet 1980.

Megjithëse feministet marksiste dhe socialiste kishin teorizuar gjatë mbi punët e shtëpisë, këto debate të reja u fokusuan më konkretisht në ekonominë politike të punëve të shtëpisë të grave në harkun më të gjerë të zhvillimit kapitalist. Në këtë kornizë, riprodhimi social është shënjuar i punës së papaguar të pastrimit, gatimit, rritjes së fëmijëve, por edhe shënjuar i pritshmërive të kujdesit të feminizuar, rehatisë dhe seksit, të cilat e bëjnë të mundur punën me pagë të burrave nëpër fabrika.

Për më shumë se katër dekada, aktivizmi i Federicit ka qenë qendror në këtë punë. Shkrimi i saj ofron një përshkrim themelor të kërkesës për pagë si akt revolucionar. Pamfleti i saj me ndikim të madh, “Pagë për punët e shtëpisë” (1975), e bën hapjen me një kundërshtim provokues: “Ata thonë se është dashuri. Ne themi se është punë e papaguar”. Në këtë dokument dhe të tjera, Federici argumenton se kërkesa për pagë është një lidhje kritike politike mbi organizimin e grave rreth një kushti të përbashkët të punës së tjetërsuar. Kërkesa për pagë është kërkesë e pamundshme për kapitalizmin, dhe ky është problemi; suksesi do të nënkuptonte një rikonfigurim të tërësishëm të shpërndarjes së pasurisë shoqërore.

“Pagë për punët e shtëpisë” është ribotuar së fundmi nga AK Press si pjesë e koleksionit *Wages for Housework: The New York Committee 1972–1977: History, Theory, Documents*, redaktuar nga Federici dhe Arlen Austin. Ky koleksion përfshin një numër broshurash, fjalimesh, gazetash, fotografish, këngësh dhe mbulimi mediatik të papublikuara më parë ose që ishin të vështira për t'u gjetur. Megjithëse koleksioni fokusohet në New York, ai përfshin gjithashtu materiale nga Los Angeles, Islanda, Italia, Gjermania dhe Londra. Tekstet shpesh refuzojnë premtimin utopik se teknologjitë e reja do të

redukojnë kohën e shpenzuar për punët e shtëpisë, duke liruar kohë për aktivitete të tjera. Siç argumentojnë Federici dhe Nicole Cox në “Counter-Planning from the Kitchen” (1975), produktiviteti i rritur i mundësuar nga teknologjitë e reja, nuk ndryshon domosdoshmërisht natyrën e izoluar të punëve të shtëpisë ose format normative familjare të prodhuara prej saj.

Në vend se të fokusohet në risitë që i bëjnë punët e shtëpisë të duken më “ndryshe”, biseda e mëposhtme merr në konsideratë teknologjitë dhe teknikat luftuese që janë zhvilluar përmes organizimit feminist mbi punën riprodhuese.

Jill Richards: Pse vendosi kolektivi juaj të organizohej veçmas nga grupet e tjera aktiviste që po bënin punë të ngjashme me juve karshi drejtësisë në punë?

Silvia Federici: Lëvizja e grave në tërësi ishte autonome, sepse ishte e qartë se shqetësimet tona nuk ishin të rëndësishme për të majtën e dominuar nga burrat. Në vitin 1969, gratë po largoheshin nga organizatat e majta, si Studentët për një Shoqëri Demokratike (SDS), sepse sa herë që gratë kërkonin një diskutim për shtypjen e tyre, ato kundërshtoheshin dhe tentonin t’i heshtnin. Ishte thelbësore që të gjitha grupet e grave të organizoheshin veçmas nga burrat; ne nuk do të kishim qenë kurrë në gjendje të zhvillonim një kuptim të formave specifike të shtypjes që vuajnë gratë në shoqërinë tonë, nëse do të kishim mbetur në organizata të përziera. Në kohën kur kolektivi ynë u formua në vitin 1973, nevoja për autonomi feministe ishte vendosur mirë.

Duke u organizuar në mënyrë autonome, ne krijuam hapësira ku gratë mund të flisnin, të dëgjonin njëra-tjetrën, të vlerësonin përvojat e njëra-tjetrës dhe të kuptonin se, ajo që kishim për të thënë, ishte e

rëndësishme. Autonomia bëri të mundur që ne të gjenim zërat tanë. Më duhet të shtoj se asnjë organizatë feministe nuk merrej vetëm me çështjen e drejtësisë së punës.

JR: A mund të flisni për mënyrën se si “Pagë për punët e shtëpisë” gjeti rrugën drejt një vendi të angazhimit të thellë ndërracor, shumë kohë përpara se ndërsektorialiteti të ishte diçka për të cilën njerëzit flisnin dhe, në një kohë kur, aktivizmi i grave ishte kryesisht i ndarë sipas linjave racore?

SF: Politika për “Pagë për punët e shtëpisë”, u formësua nga gratë që dinin mirë për kapitalizmin, imperializmin dhe luftën kundër kolonializmit. Kështu, ne nuk mund të pranohim që çlirimi i grave mund të ishte luftë për “barazi me burrat” ose se mund të kufizohej në pagë të barabartë për punë të barabartë. Ne pamë se në të njëjtën mënyrë se qysh racizmi i burrave dhe grave zezake kishte shërbyer për të justifikuar skllavërinë, po ashtu diskriminimi me bazë gjinore kishte shërbyer për të shfrytëzuar gratë si punëtoresh të papaguara në shtëpi. Kjo është arsyeja pse ne mbështetëm luftën e nënave për mirëqenie, e cila udhëhiqej nga gratë zezake - jo sepse zezaket ishin shumica e grave me ndihmë sociale, gjë që nuk ishte kështu, por sepse zezaket ishin më të gatshmet për të luftuar për të drejtat e tyre. Ishin ato që dolën në rrugë dhe thanë: “Mirëqenia nuk është bamirësi”; “Çdo grua është grua punëtoresh”. Ato thoshin, ashtu si ne, se rritja e një fëmije është punë e nevojshme shoqërore. Ato thoshin “Mos na thoni se jemi parazitë”; “Mos na thoni se jemi të varura nga shteti”; “Kur shteti ka nevojë për ushtarë, ai vjen për fëmijët tanë”; “Kur fabrikat kanë nevojë për punëtoresh, ato drejtohen kah fëmijët tanë”.

Prandaj, ato e kuptuan se “Pagë për punët e shtëpisë” do t’u jepte grave më shumë pushtet: për një kohë të shkurtër, ato do kishin më shumë para, më shumë kontroll mbi jetët e tyre, duke mos qenë të

detyruara të vareshin nga një burrë, ose të vareshin nga ndonjë punë e çfarëdoshme për të cilën ato kishin dëshpërimisht nevojë, e në terma afatgjatë, duke refuzuar vazhdimin e dhënies së punës së papaguar klasës kapitaliste. Por edhe duke refuzuar injorimin e faktit se shtëpia është një lloj fabrike, dhe se punët e shtëpisë e bëjnë të mundur çdo formë tjetër të punës, meqë ato prodhojnë punëtorët.

Kjo asnjëherë nuk ishte menduar të ishte një recetë për gratë që të mos punojnë jashtë shtëpisë. Më shumë do të thosha se, kur largoheshim nga shtëpia, do të ishim në gjendje ta bënim largimin të fuqizuar e jo nga dëshpërimi, jo se do të na duhej të pranonim çfarëdo pune që na ofrohej – vetëm për vetëm që të kishim autonomi ekonomike.

JR: A mund të komentoni për marrëdhënien më të gjerë midis lëvizjeve feministe vendase dhe ndërkombëtare, veçanërisht në aspektin e organizimit të punës?

SF: Kapitali është ndërkombëtar, ndaj edhe aktivizmi kundër kapitalizmit duhet të jetë ndërkombëtar. Kjo ishte diçka që ne e kuptuam kur formuam Kolektivin Ndërkombëtar Feminist në Padova në verën e vitit 1972.

Organizimi ndërkombëtar na lejoj të zhvillojmë një kritikë më të fortë ndaj kapitalizmit sesa mund të fitonim nga një perspektivë thjesht kombëtare. Në baza ditore, kjo do të thoshte që organizata jonë fokusohet në atë që ne mund të bënim në New York dhe Shtetet e Bashkuara më gjerësisht, por gjithashtu u përpoqëm rregullisht të kishim takime ndërkombëtare, ku mund të shkëmbejmë dokumente dhe analiza, në mënyrë që të kishim një pamje më të gjerë të betejave që ndanim të gjitha.

Edhe sot e shohim nevojën e organizimit ndërkombëtar, siç po ndodh rreth çështjes së dhunës ndaj grave. Dhuna nuk është uniforme, ajo

prekë disa gra më shumë se disa tjera. Është e qartë se dhuna prek gratë zezake, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara, shumë më intensivisht sesa gratë e bardha. Ngjashëm, ajo prek gratë në Jugun Global më ndryshe nga ato të Veriut. E megjithatë, si gra, ne të gjitha jemi rritur duke e ditur se nuk mund të dalim natën, se duhet të jemi të kujdesshme se ku shkojmë, kur, si vishemi, sepse shumë burra do të kishin liri dhe të drejtë të na ngacmojnë seksualisht. Që nga fëmijëria, gratë e brezit tim ishin të përgatitura për faktin se dhuna do të ishte një element në jetën tonë, se burrat në rrugë do të bënin komente poshtëruese ose kërcënuese për trupat tonë, se baballarët dhe burrat mund të na rrihnin dhe do kjo të tolerohej.

Një pikë kthese kryesore në organizimin feminist ishte Gjykata Ndërkombëtare për Krimet kundër Grave, që u mbajt në Bruksel në mars të vitit 1976. Organizuar nga feministet, gjykata foli për të gjitha format e dhunës, jo vetëm dhunën individuale apo në familje, por edhe dhunën e lidhur me luftërat dhe politikat institucionale. Megjithatë, një nga kufizimet e lëvizjes në Shtetet e Bashkuara ishte se ajo fokusohej kryesisht në kërkimin e dënimeve më të rënda për abuzuesit, dhe shpesh bashkëpunonte me policinë. Ky ishte një gabim. Siç e kanë bërë të qartë organizatat e grave zezake, dënimet më të rënda përfundojnë duke kriminalizuar burrat e komuniteteve tashmë të viktimizuara. Sot, thirrja e promovuar kryesisht nga feministet zezake – është për drejtësi restauruese dhe përgjegjshmëri të komunitetit.

Analiza jonë e dhunës ndaj grave bazohej në shikimin e punëve të shtëpisë si një formë e prodhimit kapitalist, dhe në analizimin e rolit të pagës në ndërtimin e organizimit familjar. Ne argumentuam se dhuna është gjithmonë latente në familje, sepse, nëpërmjet pagës, shteti i delegon burrit kompetencën për të mbikëqyrur dhe kontrollu-

-ar punën e gruas, si dhe fuqinë për ta penalizuar atë në rast se ajo nuk kryen punë. Unë do ta përshkruaja atë si një lloj rregulli indirekt: shteti ndërmjetëson kontrollin mbi gratë përmes burrit dhe pagës së tij. Jo më kot në vitet 1970-ta, gratë me ndihmë sociale e quanin shtetin “Burri”!

Kjo shpjegon pse dhuna në familje është toleruar për kaq shumë kohë dhe rrallë herë është trajtuar nga shteti si krim. Ne filluam ta shihnim përdhunimin si një formë disipline shtëpiake. Është një mënyrë e kontrollit dhe rregullimit të kohës dhe hapësirës së gruas: nuk duhet të dalësh natën vetëm pa burrin, duhet të jesh në shtëpi me fëmijët, të bësh punët e shtëpisë, të përgatitesh për të nesërmen etj. Nëse je jashtë, atëherë t’jesh e përgaditun se e dini çka ndodhë. Kërcënimi i përdhunimit është një disiplinë e pashprehur për kohën dhe hapësirën e grave.

Nuk duhet të harrojmë, gjithashtu, se dhuna ndaj grave lidhet me abuzimin e fëmijëve, popullatës tjetër të madhe që i nënshtrohet dhunës, e cila nuk njihet si e tillë. Fëmijët mund të rrihen sepse, ashtu si me gratë, shteti pranon se kjo është një mënyrë e nevojshme për t’i disiplinuar, për t’i përgatitur për format e ardhshme të eksploatimit. Dhuna ndaj grave është e vazhdueshme me dhunën ndaj të gjithë zezakëve, grave dhe burrave, megjithëse që nga skllavëria e deri më sot, kjo ka marrë forma shumë më brutale, shkatërruese. Dhuna është gjithmonë e nevojshme për t’i detyruar njerëzit të pranojnë një vend të varur në shoqëri, për të imponuar forma intensive të eksploatimit.

JR: Cilat aspekte të platformës “Pagë për punët e shtëpisë” u keqkuptuan më shpesh në atë kohë?

SF: Lëvizja më e gjerë feministe ishte e shqetësuar për përmirësimin e kushteve të grave, por jo aq e shqetësuar për transformimin e shoqërisë nga kapitalizmi. Ne e ndjenim se ishte e pamundur të

bënim të parën pa bërë të dytën.

“Pagë për punët e shtëpisë” u keqkuptua duke thënë: na jepni para që të rrimë në shtëpi, duke bërë të njëjtat punë shtëpie. Ne në fakt pagat për punët e shtëpisë i shihnim si një strategji refuzimi, si një strategji që na jep më shumë mundësi, më shumë fuqi për të vendosur se si ta organizojmë jetën tonë. Ne u akuzuam për “institucionalizimin e grave në shtëpi”, por, shumë gra që takuam, do të na thoshin se ato ishin tashmë të institucionalizuara në shtëpi, sepse pa paratë e tyre, nuk mund të shkonin askund ose nuk mund t’i linin burrat e tyre, edhe sikur të donin.

Pagat për punët e shtëpisë nuk ishin qëllimi përfundimtar për ne, siç supozuan disa kritikë - që nuk do të thotë se nuk ishte një qëllim i fuqishëm në vetvete. Ne besuam se lufta për paga për punët e shtëpisë do të ishte mënyra më e shpejtë për të detyruar shtetin të na jepte çerdhe falas dhe shërbime të tjera kryesore mbështetëse. Fatkeqësisht, lëvizja e grave ende nuk ka mundur t’i marrë ato! Mendoj se kjo është pjesërisht sepse lëvizja e vuri të gjithë energjinë e saj për të hyrë në hapësirat e dominuara nga burrat, dhe nuk u përpoq të ndryshonte kushtet e punës riprodhuese, veçanërisht në lidhje me punën në shtëpi, rritjen e fëmijëve dhe format e tjera të punës së kujdesit. Ndërkohë, shteti në vend që të ofrojë më shumë shërbime për gratë, në fakt ka reduktuar qasjen edhe në shërbimet që ishin në dispozicion. Sot, është më e vështirë të marrësh kujdesin për të moshuarit dhe fëmijët, se sa ishte në fund të viteve 1960.

Strategjia jonë ishte të luftonim në terrenin ku gratë janë më të forta, për çështje që na prekin të gjithëve, si puna në shtëpi, seksualiteti, rritja e fëmijëve, si dhe puna e paguar. Kur çështja e pushimit të paguar të lehonisë shkoi në Gjykatën e Lartë në vitin 1976, pak feministe e mbështetën atë sepse kishin frikë se, nëse do t’u jepeshin

këto "privilegje", nuk do të kishin të drejtë të kërkonin barazi.

Megjithatë, kur gratë po hynin në punë me pagë masivisht në fillim të viteve 1980, ato zbuluan se "barazia" mbetej e pakapshme, sepse atyre iu duhej të kryenin ende shumë punë të papaguara në shtëpi, duke u kujdesur për fëmijët, të afërmit. Dhe pastaj ato duhej t'i luftonin betejat e tyre veç e veç, secila në vendin e saj të punës, dhe kjo ndodhte në një kohë kur po përmysej i gjithë organizimi i punës për shkak të globalizimit. Asokohe, ndodhte edhe çmontimi i kompleksit industrial në Shtetet e Bashkuara, me punët që shkonin jashtë vendit, me shkurtimin e shërbimeve nga shteti - kështu që gratë po hynin në fuqinë e punës në momentin kur çatia e fabrikës po rrëzohej.

JR: Në çfarë mënyrash u ndihmua apo pengua aktivizmi juaj nga teknologjia e asaj kohe?

SF: Është e vështirë të thuhet. Por nuk mendoj se mungesa e kompjuterëve dhe e internetit ishte problem. Kjo nënkupton se ne kalonim më shumë kohë duke folur me gratë në rrugë, në lavanderitë dhe vende të tjera ku mblihdeshin ato. Mendoj se takimet sy më sy ishin shumë të rëndësishme; këto na ndihmuan në krijimin e një komunikimi më të mirë se sa ajo që interneti të mundëson. Në përgjithësi, mendoj se interneti konsumon shumë nga koha jonë, por jo domosdoshmërisht në mënyra më produktive politikisht. Ne jemi të zhytur në më shumë informacion sesa mund të përballojmë, kemi kërkesa të vazhdueshme, të cilave nuk mund t'u përgjigjemi, ose na detyrojnë të bëhemi shumë sipërfaqësorë në përgjigjet tona. Për më tepër, kam ende tufa letrash që kam shkëmbyer me gra në Angli, Itali dhe Kanada, dhe disa prej këtyre letrave janë si artikuj në mënyrën se si ato analizojnë situatën politike në këto lokalitete – kishte shumë analizë në ato letra. Nuk ka asgjë të tillë sot. Thënë këtë, nuk dyshoj

se interneti dhe kompjuterët gjithashtu po hapin mundësi të reja.

Intervista me Silvia Federicin dhe shkrimi i artikullit janë bërë nga Jill Richards.

Përkthyer në shqip nga Medinë Dauti.

Skanoni kodin më poshtë për të lexuar artikullin original në gjuhën angleze.



2



**RIMENDIMI I
GJINISË, ..
RACËS DHE
KLASËS
NGA KONCEPTI I PUNËS**

Intervistë e Jule Goikoetxea me Nancy Fraser

Jule Goikoetxea: Mirëdita, e dashur Nancy. Shumë faleminderit që pranuat këtë intervistë për numrin special të Capital and Class. Ky numër i veçantë përqendrohet në 13 tezat feministe marksiste, të cilat i diskutuam gjatë Konferencës së Katërt Ndërkombëtare Feministe Marksiste. Në librin tuaj të ri, *Tri fytyrat e punës: Zbulimi i lidhjeve të fshehura ndërmjet gjinisë, racës dhe klasës*, trajtoni çështje si puna, lufta e klasave, prodhimi dhe riprodhimi, ndërthurja, ndryshimet klimatike, perandoria, demokracia, feminizmi dhe antiracizmi. Këto tema ishin gjithashtu në qendër të kësaj konference.

Nancy Fraser: Shumë mirë. Gëzohem që po flasim.

Jule Goikoetxea: Edhe unë gëzohem që ju shoh përsëri.

Nancy Fraser: Kanë kaluar shumë vite? Është e mrekullueshme që po takohemi sërish.

Jule Goikoetxea: Të gjithë autorët që do të paraqiten në këtë numër special morën pjesë në konferencë. Artikujt e tyre trajtojnë më thellë mënyrën se si kuptojmë punën, klasën, gjininë dhe racën, me qëllim zgjerimin e proceseve gjithëpërfshirëse emancipuese. Në këtë frymë, do të doja t'ju pyes disa pyetje mbi temat e konferencës dhe më pas të flasim për përmbajtjen e librit tuaj të ri.

Sigurisht. Ideja kryesore është të zgjerojmë kuptimin tonë për kapitalizmin, duke mos u ndalur vetëm në kontradiktat dhe format e shtypjes që burojnë nga dimensionet ekonomik i shoqërisë, por duke shqyrtuar edhe marrëdhëniet mes ekonomisë dhe aspekteve të tjera të jetës sociale. Prej këndvështrimit tim feminist, kjo është mjaft e njohur. Është thelbësore të shqyrtojmë lidhjen mes punës së paguar dhe asaj të papaguar kjo është mjaft e njohur. Është thelbësore të shq-

yrtojmë lidhjen mes punës së paguar dhe asaj të papaguar ose të nënpaguar, si dhe marrëdhëniet mes ekonomisë dhe natyrës, dimensioneve ekologjike, apo kufizimeve të vendosura mbi demokracinë. Për shembull, kapitalizmi krijon patologji politike që lidhen me këto kufizime.

Ju përmendët racën dhe perandorinë, si dhe marrëdhënien midis ekonomisë dhe organizimit më të madh gjeografik të botës rreth linjës globale të ngjyrave (global color line) – një term i përdorur nga Du Bois, i cili ndan racat në mbarë botën. Të gjitha këto dalin në pah kur e mendoni kapitalizmin si diçka më të madhe se një ekonomi, duke përfshirë të gjitha këto si arena mbështetëse që mundësojnë funksionimin e ekonomisë. Por problemi qëndron në faktin se ky relacion i krijuar është shumë kontradiktor, pervers dhe destabilizues. Ekonomia, borxhi dhe i gjithë organizimi i kapitalizmit janë strukturuar, le të themi, për të inkurajuar dhe ushtruar presion të madh mbi aktorët e fuqishëm ekonomikë – investitorët e mëdhenj, korporatat – duke i ftuar në mënyrë implicite që të "kanibalizojnë" këto burime. Sistemi i nxit ata të shfrytëzojnë natyrën, të përfitojnë nga puna, të grabisin tokat dhe burimet e indigjenëve dhe popullatave të racizuara apo të pushtuara, si dhe të minojnë demokracinë. Këto janë elementët që i duhen sistemit për të funksionuar, por njëkohësisht sistemi është i ndërtuar për t'i gllabëruar, varfëruar dhe dëmtuar këto burime pa asnjë detyrim për t'i riparuar. Kjo është ajo që nënkuptoj me "kanibalizim." Është një dinamikë ku sistemi gllabëron vetë kushtet e veta të mundësisë – që, për fat të keq, janë edhe kushtet e jetës sonë, me të cilat kemi një lidhje dhe një qëllim. Kjo tendencë e rrënjosur drejt vetëdestabilizimit nuk është aspak rastësore.

Jule Goikoetxea: Tani, sa i përket librit tuaj të ri, *Tri Fytyrat e Punës Kapitaliste: Zbulimi i Lidhjeve të Fshehura ndërmjet Gjinisë, Racës dhe Klasës*, përmbajtja bazohet në Leksionet e Benjaminit, një pozitë e përkohshme në Qendrën për Shkenca Humane dhe Ndryshime Sociale në Universitetin Humboldt në Berlin. Në këto leksione, qëllimi juaj ishte të zhvillonit konceptin e punës. Ju shtruat pyetjen: "Ndoshta po pyesni veten: Pse puna? Pse ta bëjmë atë koncept të stërvjetëruar pikënisje për rimendimin e gjinisë, racës dhe klasës? A nuk është kjo një perspektivë që i jep përparësi klasës mbi gjininë dhe racën? Dhe më tej, pse triada ka nevojë të rimendohet në radhë të parë?"

Nancy Fraser: Epo, më herët përmendët konceptin e ndërthurjes. Mendoj se ajo që po shohim sot është një dëshirë e theksuar për korniza më gjithëpërfshirëse. Njerëzit kërkojnë mënyra për të promovuar bashkëpunim dhe integrim më të madh ndërmjet betejave për drejtësi riprodhuese, luftës kundër dhunës gjinore, luftës kundër racizmit, luftës për mbrojtjen e mjedisit dhe shumë kauzave të tjera. Ndërkohë, ekziston një energji e madhe emancipuese, por ajo shpesh është shumë e shpërndarë dhe e fragmentuar. Ky fragmentim ka ndodhur pas disa dekadash ku njerëzit ndjenin nevojën për të artikuluar në mënyrë të pavarur perspektivat e tyre, pa ndërhyrje nga aktorë më të fuqishëm. Ndërsa kjo periudhë ka sjellë shumë përfitime, si rritja e ndërgjegjësimit dhe diversifikimi i pikëpamjeve, ajo gjithashtu na ka lënë në një situatë të fragmentuar. Tani po shohim një tendencë drejt integritit, e cila reflektohet në rritjen ose rishfaqjen e qasjeve si feminizmi riprodhues social, feminizmi marksist, teoritë e kapitalizmit racor, ekosocializmi, ekofeminizmi dhe ndërthurja.

Këto paradigma përpiqen të ofrojnë qasje më integruese, edhe pse asnjëra prej tyre nuk është ende e përsosur. Në librin tim të ri, përpiqem të eksploroj këtë impuls për integrim përmes konceptit të punës. Hipoteza ime është se kapitalizmi mbështetet në tre forma kryesore të punës, të cilat janë të ndërthurura funksionalisht. Së pari, puna e shfrytëzuar përfaqëson atë që marksistët tradicionalisht e kanë konceptuar si punën e lirë të klasës punëtore në prodhimin e mallrave për fitim. Kjo është sigurisht një fytyrë thelbësore e punës kapitaliste. Së dyti, puna e shpronësuar përfshin punën gjysmë të lirë ose jo të lirë, shpesh të kryer nga popullata të raciaizuara dhe të shpronësuar, që kapitali i merr ose i shfrytëzon pa kosto të plota. Së fundi, kemi punën shtëpiake, ose siç e kanë quajtur feministët, punën riprodhuese sociale. Ekzistojnë të paktën këto tre forma themelore të punës dhe kapitalizmi nuk mund të funksionojë pa të gjitha këto. Feminizmi e kuptoi lidhjen midis punës së kujdesit dhe të eksploatuar. Ne jemi përpjekur ta teorizojmë këtë për një kohë të gjatë dhe antiracistët kanë menduar për marrëdhënien midis punës së lirë dhe jo të lirë për një kohë të gjatë. Ajo që propozoj është një kornizë që tregon sesi këto forma të punës jo vetëm që bashkëjetojnë, por janë funksionalisht të lidhura, edhe pse popullatat që i kryejnë ato ndahen nga njëri-tjetri sipas racës, gjinisë etj. Ky integrim na lejon të kuptojmë që padrejtësitë gjinore, racore dhe klasore nuk janë të rastësishme, por rrjedhojnë drejtpërdrejt nga mënyra kapitaliste e organizimit të shoqërisë dhe punës. Kjo është një perspektivë integruese. Ideja është që kapitalizmi i kuptuar në këtë mënyrë, zbulon disa lidhje të fshehura të gjinisë, racës dhe klasës.

Hipoteza ime është se ky organizim i punës sociale dhe ndarjet që ai ngulmon brenda emetimeve të klasës punëtore të racës, gjinisë, e kështu me radhë, që formojnë një teori unitare, ndryshe nga sistemet e shumta. Kjo na tregon se si krijohen gjinia, raca dhe klasa. Jo rastësisht. Nga kapitalizmi, nga kjo formë organizimi shoqëror. Pra, kjo është ideja që trajtoj në këto leksione dhe në librin tim.

Jule Goikoetxea: Sipas Marksit, vlera e produktit të përgjithshëm shoqëror përcaktohet nga koha mesatare e nevojshme e punës shoqërore për ta prodhuar atë, pavarësisht nëse çmimi i shitjes së mallrave në sektorë të ndryshëm është mbi ose nën vlerën e tyre të këmbimit. Megjithatë, një problem që shfaqet është se koha mesatare e nevojshme për të riprodhuar vetë punëtorët është e vështirë për t'u matur ose formalizuar, sepse zakonisht konsiderohet se nuk krijon "vlerë prodhuese." Ju argumentoni se ndarja midis punës prodhuese dhe asaj riprodhuese përforcon idenë se vetëm një lloj pune ka aftësinë të krijojë vlerë në kapitalizëm. A mund ta shpjegoni më tej këtë ide? Gjithashtu, përse, pavarësisht nga kjo kritikë, ju vazhdoni të quani "punë riprodhuese" të gjitha ato aktivitete që kryhen nga trupa të racizuar dhe seksualizuar?

Nancy Fraser: Pra, pse e bëj apo pse jo?

Jule Goikoetxea: Pse, nga njëra anë, kritikoni ndarjen mes punës prodhuese dhe riprodhuese, dhe nga ana tjetër e quani punë riprodhuese sociale të gjithë punën e papaguar, e cila kryhet kryesisht nga gratë dhe njerëzit e racizuar? Pikërisht për këtë arsye quhet punë riprodhuese, sepse, sipas jush, ka gjithashtu punë të paguar që është gjithashtu riprodhuese. Pra, pse e quani riprodhuese, nëse ajo mund të prodhojë mbivlerë kur paguhet?

Nancy Fraser: Në rregull, problemi që po përmendni është se ky dallim mes punës prodhuese dhe riprodhuese është krijuar nga kapit-

alizmi. Nuk mendoj se ka ekzistuar ndonjëherë në një kuptim të thellë para kapitalizmit. Unë besoj se një shoqëri e vërtetë post-kapitaliste do të duhej, nëse jo ta shfuqizonte plotësisht, të paktën ta riimagjinonte këtë dallim rrënjësisht. Pra, ne jetojmë në një shoqëri që ka rrënjësuar këtë ndarje dhe kjo nuk është thjesht një ideologji, por një ndarje e institucionalizuar. Prandaj, për të kuptuar se si funksionon shoqëria dhe për të hartuar strukturën dhe dinamizmin e saj, duhet ta përdorim këtë dallim. Megjithatë, nuk e miratojmë këtë ndarje; përkundrazi, mendojmë se ajo është rrënja e shtypjes. Por, për shkak të mënyrës se si është organizuar shoqëria, duhet të flasim për këtë ndarje. Unë përpiqem të jem e kujdesshme që të mbaj të dyja anët e kësaj fotografie kur përshkruaj shoqërinë. Gjithashtu, po përpiqem të tregoj se si teoria e vlerës që lidhet me këtë dallim është shumë problematike, dhe po e trajtoj me kujdes dallimin mes pasurisë dhe vlerës. Kjo është një fushë ku Marks i përdor termin "pasuri" si një term të përgjithshëm, që nuk lidhet veçmas me kapitalizmin. Në të kundërt, "vlera" është një term kapitalist dhe lidhet me procesin e akumulimit të kapitalit, ku përfshihet edhe procesi i monetizimit të punës. Ajo që po përpiqem të tregoj është se si kapitali, përmes aktorëve kapitalistë, merr pasurinë dhe e shndërron atë në vlerë. Ky është procesi që ndodh me punën, ku ata nuk paguajnë për kostot e riprodhimit të saj, përveç në disa regjime socialdemokrate, por në shumicën e rasteve ata gjejnë mënyra për ta shmangur këtë, madje edhe me pasoja sociale. Po ashtu, është e rëndësishme të kuptojmë dallimin mes vlerës së tepërt dhe fitimit. Unë pranoj mendimin marksist ortodoks që vlera e tepërt krijohet nga orët shtesë të punës që kapitali nuk i paguan, duke lënë anash kostot e jetesës për punëtorët.

Kapitalisti përvetëson këtë vlerë të tepërt, por vlera e tepërt nuk është e vetmja çështje. Në perspektivën që po zhvilloj, unë fokusohem më shumë tek fitimi dhe komponentët e tij, të cilët përfshijnë edhe ato inpute të tjera, si kostot e riprodhimit ekologjik dhe të tjera që kapitalisti kurrë nuk i paguan. Kështu që fitimi përfshin shumë më tepër se vlerën e tepërt. Ai përfshin kostot që shoqëria dhe punëtorët paguajnë, përfshirë kostot e energjisë dhe përkujdesit ekologjik, si dhe shërbimet publike. Kapitalistët shpesh shmangin këto pagesa, duke i ngarkuar ato mbi klasën punëtore, e cila është e detyruar të paguajë taksat dhe të përballojë këto kosto. Prandaj, ky është një element i fitimit që është më i gjerë se vlera e tepërt, dhe marksistët ortodoksë shpesh fokusohen vetëm në këtë të fundit, duke lënë pas shumë nga aspektet e tjera të kapitalizmit.

Jule Goikoetxea: Pra, kjo çon në pyetjen tjetër për të cilën flisni në leksionin e dytë të Benjamins: tre lëvizjet e punës. A mund të thellohesh në këtë?

Nancy Fraser: Po, mendoj se duhet të kisha thënë më herët se jam frymëzuar për të zhvilluar këtë qasje nga W.E.B Dubois. Kam dhënë mësim për "Rindërtimin e Zi", që mendoj se është kryevepra e tij nga viti 1935. E vendos atë aty me historinë e Trosky-it mbi Revolucionin Rus si një nga kryeveprat e mëdha të historiografisë marksiste. Do të doja që të lexohej dhe diskutohej më gjerësisht. Është një libër që trajton ngjarje amerikane, prandaj mund të mos ketë vëmendjen globale që meriton. Megjithatë, idetë e Dubois janë të jashtëzakonshme. Ai ofron një histori të Luftës Civile Amerikane të shekullit të 19-të, ku trajtohet e gjithë trajektorja nga lufta civile dhe heqja formale e skllavërisë, përpjekja përmes rindërtimit rrënjësor për

të transformuar marrëdhëniet shoqërore, politike, ekonomike dhe pronësore në Jug, në mënyrë që emancipimi i skllëvërve të bëhet një realitet dhe jo vetëm një akt formal. Kjo vazhdon për disa dekada, deri në atë që ai e quan kundërrevolucioni i pronës, ku kryeqyteti verior e braktis aleancën dhe refuzon ta mbështesë. Krijohet një krizë politike dhe pushteti u kthehet klasave mbjellëse në Jug, duke rivendosur supremacinë e tyre të bardhë. Kjo është një histori e jashtëzakonshme. Shumë njerëz e kanë treguar historinë, por ajo që bën Dubois është e vërtetë e jashtëzakonshme. Ai thotë se në shekullin e 19-të, Shtetet e Bashkuara kishin dy lëvizje punëtore: lëvizjen sindikaliste, që së shpejti do të krijonte një lëvizje të re socialiste, dhe abolicionizmin, luftën kundër skllavërisë, që është gjithashtu një lëvizje punëtore. Dubois zhvillon idenë që këto janë dy forma thelbësore të punës në kapitalizëm, dhe ato janë të rëndësishme për të kuptuar gjithçka së bashku në akumulimin e kapitalit. Ai tregon se nuk mund të kemi Manchester pa Mississippi; Manchester i Anglisë Veriore, ku Engels-i shkroi për fabrikat satanike të tekstilit, që përdorin pambuk të papërpunuar që prodhohet me çmim të lirë në plantacionet e skllëvërve në Mississippi. Ky është një shembull i dukshëm i ndarjes mes prodhimit industrial dhe nxjerrjes së lëndëve të para, që në të vërtetë janë pjesë të një motori ekonomik dinamik. Por lëvizjet punëtore, që nuk e shohin këtë lidhje, nuk e kuptojnë se janë të lidhura dhe se të dyja janë pjesë të një sistemi. Nëse këto dy lëvizje do të kishin bashkuar forcat, historia e Shteteve të Bashkuara dhe e botës kapitaliste mund të kishte qenë ndryshe.

Kjo është një ide e fuqishme për të kuptuar momentet kur lëvizjet nuk e njohin njëra-tjetrën.

Tani, ndoshta mund të shihni se perspektiva ime feministe po ndikon dhe thotë: "Po, kjo është e vërtetë, por pse vetëm dy lëvizje? Pse jo tre?" Sepse gjithë këto dekada pune të madhe nga feministët për punën e kujdesit dhe punës riprodhuese, dhe sigurisht, dy djem nuk e shohin as punën riprodhuese të skllavëruar. Dubois e teorizon këtë në disa pasazhe, por nuk e ka përfshirë si pjesë të konceptualizimit të tij. Pra, pse jo tre lëvizje punëtore? Dhe mund ta mendojmë feminizmin si një lëvizje punëtore të panjohur, jo vetëm nga të tjerët, por ndoshta edhe nga vetë ajo apo nga pjesë të mëdha të saj? Dhe nëse po, cilat janë perspektivat sot për këtë? Kjo mund të inkurajojë aktivizmin anti-racist, feminist, sindikalist dhe të tjera që të mendojnë për veten si lëvizje të punës. Secili prej tyre është si një motor, si të thuash, një piston në të njëjtin motor që është kapitalizmi dhe kjo flet për atë që po flisnim më parë, mundësinë e një mënyre më të integruar të të menduarit. Pra, kjo është ajo që unë u përpoqa të argumentoja në këto leksione, po sikur ne feministët të mendonim për shumë nga ato që po bëjmë si një formë lufte pune? Dhe çfarë nëse aktivistët anti-racist mund ta kuptojnë se abolicionizimi i burgjeve dhe dhuna policore janë forma të luftës së punës? Po lëvizja sindikaliste? Po sikur këto tri lëvizje të kuptonin veten dhe njëra-tjetrën si anëtare kolege të punës? A mund të mendonim për një ide më të zgjeruar të klasës punëtore, që nuk është vetëm segmenti i eksploatuar, por edhe këto segmente të tjera? Dhe si mund të kapërcejmë ndarjet e brendshme politike? Kjo është hipoteza ime.

Jule Goikoetxea: Kjo është shumë interesante, dhe procesi i emancipimit duhet të jetë, përsëri, aq i gjerë sa të mundemi.

Megjithatë, këtu lindin probleme, sidomos kur flasim për familjen. Sipas shifrave të fundit të Kombeve të Bashkuara, 85% e punës së papaguar kryhet nga gratë në mbarë botën dhe brenda familjes, e cila shihet si një institucion social. Ky është gjithashtu një institucion ku kryhen më shumë se 78% e rasteve të dhunës ndaj grave, e cila ushtrohet nga familjarët e tyre, kryesisht nga burra të klasës punëtore. Pra, familja bëhet vendi kryesor i dhunës së drejtpërdrejtë ndaj grave dhe një nga vendet kryesore të shpronësimit të grave përmes punës shtëpiake të papaguar. Si mendoni, cili mund të jetë propozimi juaj për familjen moderne heteronukleare?

Nancy Fraser: Po, absolutisht. Mendoj se kjo është pyetja. Jam plotësisht dakord që familja është, në shumë pjesë të botës, vendi kryesor i punës së kujdesit, ose punës riprodhuese, që unë e quaj punë shtëpiake. Kjo është e vërtetë, dhe gjithashtu është e qartë që dhuna gjinore është shumë e përhapur në këtë kontekst. Megjithatë, thelbi i argumentit tim është aspekti i punës: ka një masë të madhe të punës që kryhet, në mënyrë të dërrmuese, nga gratë në mjediset shtëpiake, ose, kur është me pagesë, shpesh me kushte shumë të ulëta dhe pa të drejta pune. Gratë janë gjithashtu të ekspozuara ndaj dhunës dhe cënueshmërisë në këto kushte. Edhe nëse puna nuk bëhet në shtëpinë e familjes, mund të jetë shtëpia e punëdhënësit tuaj, ku pastroni ose kujdeseni për fëmijët, dhe ku mund të përballeni me abuzim. Ky është një problem serioz që duhet trajtuar. Për mua, kjo është një arsye e fortë për të mbështetur një mënyrë feministe të menduarit. Nuk po sugjeroj që feminizmi duhet të shndërrohet në një lëvizje për të drejtat e këtyre "punëtorëve/eve" që sapo përshkruam, por për të drejtat e ty-

re për të qenë të lirë/a nga dhuna dhe për të pasur kushte pune të sigurta. Ata/o duhet të kenë mundësi për punë të paguar që nuk i mbajnë të mbyllur/a në shtëpi. Ata/o duhet të kenë qasje në shoqëri dhe mundësi për një jetë pa dhunë. Kjo është ajo që dua të them me feminizmin si një lëvizje punëtore. Mendoj se duhet t'i shohim të drejtat riprodhuese, përfshirë të drejtën për abort, si të drejta pune që lidhen me aftësinë për të kontrolluar trupin dhe për të kontrolluar punën riprodhuese. Lëvizja #MeToo, për shembull, ka të bëjë me të drejtat e punës. Ka të bëjë me të drejtën për të pasur një vend pune pa sulme seksuale, ngacmime dhe dhunë. Për çudi, disa nga këto çështje nuk janë parë si çështje pune deri tani. Por, në momentin që i mendojmë ato në këto terma, bëhet e qartë se ato mund të shihen si çështje pune, dhe kjo është një mënyrë e rëndësishme për t'i kuptuar. Problemi është se puna e kujdesit shpesh shihet si "mospunë" në kapitalizëm. Ky asociim ideologjik është kaq i fuqishëm sa na pengon të shohim atë si pjesë të sistemit të punës. Një nga luftërat më të mëdha historike është bërë që të kuptohet se edhe sindikalistët e lirë normativë duhet të jenë të lirë nga dhuna. Gratë kanë luftuar gjatë për këtë çështje. Po ashtu, vendet e punës janë të mbushura me dhunë dhe kjo nuk duhet të ndodhë. Një pikë e rëndësishme që dua të theksoj është se mund të lindë pyetja nëse ka një konflikt të fortë midis grave që i nënshtrohen kushteve të tmerrshme në familje dhe burrave apo baballarëve të tyre. Ajo që dua të them është se këta burra shpesh janë kryesit e dhunës, dhe kjo është një e vërtetë që duhet ta ndalojmë. Por nuk mendoj se ata janë përfituesit kryesorë të kësaj situatë. E njëjta gjë vlen për punëtorët e bardhë dhe të zi. Disa punëtorë të bardhë janë racistë dhe janë pjesë e sulmeve raciste ndaj

anëtarëve të klasës punëtore të zezë, por këta punëtorë kanë shumë më tepër për të fituar sesa për të humbur, nëse mund të kuptojnë se ata janë aleatët e mundshëm të tyre. E njëjta gjë është e vërtetë me burrat dhe gratë e klasës punëtore. Pavarësisht modeleve patriarkale dhe shtypëse, përfituesi kryesor është kapitali. Këta kryefamiljarë shpesh janë njëfarë "zot" mbi gratë, fëmijët dhe vajzat e tyre, duke u sjellë si mbretër në kështjella. Megjithatë, ne nuk mund të justifikojmë asnjë prej këtyre veprimeve. Nëse nuk mund të kuptojmë se shumica e njerëzve, përfshirë ata që bëjnë gjëra të këqija, janë gjithashtu viktima të këtij sistemi dhe kanë diçka për të fituar nga transformimi i tij, nuk do të mund ta ndryshojmë botën.

Jule Goikoetxea: E ndaj idenë se përfitimet do të ishin universale në këtë kuptim, nëse të gjithë e kuptojmë këtë. Por përsëri, ekziston gjithmonë një përballje dhe për këtë arsye kemi rryma të ndryshme feministe. Nga njëra anë, ka teori dekoloniale dhe komunitare që janë më afër teorisë së "imbrikimit", nga e cila është zhvilluar edhe feminizmi materialist, dhe nga ana tjetër, ka një ndarje më të thellë ndërmjet rrymave, mes atyre që mendojnë se burrat dhe gratë janë krijuar dhe mund të shuhen, dhe atyre teorive, si teoria unitare, e cila mendon për një botë të emancipuar ku nuk do të ketë kapitalistë dhe proletarë, por do të ketë gra dhe burra. Në këto teori marksiste unitare, gratë dhe burrat nuk bëhen, por lindin dhe kështu nuk mund të zhduken. Sipas këtij kuadri të fundit, përfituesit e vetëm të punës së papaguar të grave janë kapitalistët, jo burrat punëtorë. Por atëherë, pse burrat që punojnë kanë më shumë kohë, më shumë paga, më shumë hapësirë, më shumë prestigj, më shumë pushtet dhe arsim të lartë sesa gratë që punojnë në mbarë botën?

Nancy Fraser: Ne jemi dakord mbi këtë. Por pyetja është se si t'i përgjigjemi politikisht kësaj?

Jule Goikoetxea: Ne përpiqemi ta bëjmë këtë duke prodhuar një kornizë në të cilën jo e gjithë shtypja dhe shfrytëzimi mund të reduktohen në një të keqe, kapitalizëm, pasi ne nuk mendojmë se kapitalizmi shpik gratë, dhe kështu, gratë nuk do të zhduken kur kapitalizmi të bjerë. Prandaj, ne përpiqemi të organizojmë lëvizje autonome, si lëvizja feministe, të cilat janë të koordinuara me lëvizjet rinore, së bashku me sindikatat klasike, organizatat e ndryshimeve klimatike, sindikatat vendase të punës, lëvizjet e pensionistëve, etj. Unë mendoj se ndoshta problemi i copëzimit është përbërës i kësaj teorie unitare, pasi ajo i redukton të gjitha kompleksitetet e botës sonë në një kauzë, një kauzë që nuk është në gjendje të bashkojë beteja të tjera. Pyetja është pse. Nga ana tjetër, kompleksiteti nuk do të thotë fragmentim. Ne mund të politizojmë dhe të veprojmë në mënyrë strategjike brenda këtij kompleksiteti që nuk e redukton të gjithë të keqen në një kauzë, pasi reduktimi do të thotë përjashtim. Në çdo rast, çfarë lloj strukture institucionale duhet të ndërtojnë këto lëvizje për të vendosur një proces të vazhdueshëm emancipimi? Me fjalë të tjera, çfarë organizimi institucional do të propozonit, duke pasur parasysh krizën e sindikatave, partive politike dhe arkitekturës politike liberale, dhe duke marrë parasysh dukshëm ndjenjën e impotencës dhe acarimit, e cila është shumë e përhapur?

Nancy Fraser: Unë kam një ide shumë të qartë për këtë. Po e nis nga fakti se ka shumë aktivizëm dhe energji emancipimi, ose potencialisht emancipuese. Dhe mendimi im fillestar është se si mund të imagjinojmë më shumë bashkëpunim dhe integrim të atyre qëllimeve

më të përbashkëta? Me këtë nuk dua të them se duhet të ndodhë një shkrimje e plotë apo diçka e tillë. Ky është mendimi im i parë. Jam gjithashtu shumë e ndikuar nga ideja gramshiane e një blloku kundërhegemonik. Dhe kështu, ju e dini, kjo është historikisht e pranishme në të gjithë mendimin socialist marksist, ku Lenini kishte një problem se si të krijonte një aleancë agrare-punëtore. Gramsci ka një pyetje: Si i bashkoni fshatarët sardinezë dhe punëtorët e Fiat-it të Torinos? Unë mendoj se kemi një problem të ngjashëm, pasi ka shumë terma të ndryshëm dhe ata janë të gjithë viktima të të njëjtit sistem shoqëror, sipas mendimit tim. Nuk po përpiqemi të themi se nuk ka dallim mes punëtorëve dhe fshatarëve, por ata kanë interesa të përbashkëta të mjaftueshëm për t'u lidhur dhe për të sfiduar rreshtimet politike të zakonshme që i mbajnë ata të ndarë. Kështu mendoj unë. Ky është modeli im për të formuar një kundër-blok. Dhe ideja strategjike këtu është se unë jam me të vërtetë e interesuar për kundër-pushtetin, jo për tërheqjen, marrëveshjen, apo daljen në një margjinë dhe ndërtimin e një perspektive të përbashkët mbijetese apo diçka të tillë. Për mua, kjo është romantike. Do të ishte mirë nëse kjo parafiguron disa gjëra të mira që shoqëritë socialiste mund të duan të përfshijnë, por nuk mendoj se ka ndonjë alternativë ndaj përbashkjes me FMN-në. Nuk mund t'u shpëtosh atyre, janë shumë të mëdhenj. Tentakulat e tyre janë kudo dhe je shumë e kapur kur përpiqesh të tërhiqesh. Ata nuk të japin shumë hapësirë për të transformuar vërtet shoqërinë. Duhet të çmontojmë FMN-në. Duhet të çmontojmë Royal Shell, ExxonMobil, Google dhe Amazon. Pra, çështja këtu është përbashkja me ta përmes kundër-fuqisë. Në teori, shumica dërrmuese e racës njerëzore duhet të ketë interes të jetë në anën tjetër

të asaj fuqie. Ata nuk po përfitojnë shumë prej saj. Edhe nëse i rrahin gratë e tyre herë pas here, ata do të kishin një jetë shumë më të mirë nëse ne mund ta bëjmë këtë ndryshim. Kështu që unë dua të shoh shumë lloje të ndryshme organizatash. Mendoj se partitë politike janë të rëndësishme. Dhe, edhe pse gjërat shkuan keq në fund, më bëri shumë përshtypje që në fillim Podemos tentoi të ndërmarre një lëvizje radikale të veprimit të drejtpërdrejtë dhe ta shndërronte atë në një forcë më të përhershme dhe të institucionalizuar, sepse alternativa që kishim në Shtetet e Bashkuara ishte parku i dytë Zuccotti dhe vendet e tjera u pastruan. Ky ishte fundi. E dini, nuk kishim një organizatë. Kështu që Davos përfundoi si zhgënjyes në shumë mënyra, por gjithsesi. Pra, unë jam e interesuar për formimin e partive. Unë jam e interesuar për sindikatat. Jam shumë e inkurajuar nga përpjekjet e reja të sindikatave në Shtetet e Bashkuara, në sektorë që nuk janë organizuar kurrë më parë, si shpërndarja, shitja me pakicë, etj. Dhe kjo është shumë emocionuese. Këto përpjekje shpesh udhëhiqen nga të rinjtë, njerëzit me ngjyrë dhe gratë. Pra, është një fytyrë tjetër e sindikalizmit. Tani, nuk e di çfarë po ndodh diku tjetër, por shikoni, kemi lëvizje indigjene shumë mbresëlënëse në shumë pjesë të botës dhe ato janë në aleancë me një lloj rryme urbane, moderniste dhe ekologjike. Dhe kjo është një aleancë shumë interesante. Dua ta lë krejtësisht të hapur se si dhe në çfarë forme bashkëpunojnë këto forca të ndryshme. Sigurisht që nuk jam në favor të një partie leniniste apo diçkaje të tillë, por mund të ketë një moment kur do të ishte e përshtatshme të formohej një parti politike, shpresoj shumë demokratike, e drejtuar nga baza. E gjithë kjo ndërlikohet edhe më shumë nga fakti se nuk do të ndodhë në një vend.

Ne kemi nevojë për një bllok ndërkombëtar, që i bën gjërat shumë të komplikuara. Prandaj them se nuk kam një ide të qartë, por kam disa instinkte.

Jule Goikoetxea: Po jemi gjithashtu dëshmitarë të shfaqjes së sindikatave të strehimit për shkak të dëbimeve dhe ka gjithashtu gjëra më të vogla, ato lëvizje të reja që Harvey thotë se po ndodhin në sferën e realizimit të vlerës, që ka shtuar në kapitalizmin tonë të shërbimeve dhe financave. Në këtë kapitalizëm kanibal, duhet të shtojmë dimensionin digjital: si po ndryshon gjithçka në nxjerrjen e vlerës, ku këto korporata të mëdha si Google, Amazon, Meta, marrin nga ne diçka që quhet të dhëna, një burim i pakufizuar, i cili nuk mbaron ashtu siç mbaron nafta, dhe për këtë arsye shtrohet pyetja se si do të krijojmë një kundërfuqi ndaj kësaj fuqie digjitale. Si do të duken barrikatad digjitale?

Nancy Fraser: Po, jam shumë e impresionuar nga gjithë puna shumë e mirë që po bëhet mbi këtë çështje. Për shembull, libri i Shoshana Zuboff mbi Kapitalizmin e Mbikëqyrjes. Ai është një përshkrim shumë i mirë i kësaj teme. Ka disa gjëra më të reja që janë gjithashtu interesante. Është e vërtetë që nuk kam punuar drejtpërdrejt mbi këtë, por nuk mendoj që teknologjia vetë është një dimension i rrezikshëm dhe i keq. Mendoj se disa nga këto teknologji mund të përdoren, mund të mobilizohen ndryshe për qëllime të ndryshme, të shkëputura nga akumulimi i fitimit dhe kështu me radhë. Por kjo kërkon përsëri një lloj tjetër transformimi social për ta marrë këtë teknologji dhe për të parë se çfarë, nëse ka diçka të mirë, mund të bëhet prej saj. Tani, ajo është nën kontrollin e atyre forcave korporative të lidhura me format e reja të shfrytëzimit.

Shtetet e Bashkuara tani janë në një moment vërtet të çuditshëm krize politike. Kishim dënimin e Trump-it dje (qershor 2023) për këto akuza lidhur me dokumentet e klasifikuara. Kemi një përqindje të rëndësishme prej 37% të njerëzve që besojnë se kjo është një gjueti shtrigash politike dhe ajo që bëri ishte krejtësisht e drejtë dhe duhet të mbyllim Hillary Clinton-in. Pra, njerëzit në këtë vend duket sikur jetojnë në dy universitete të ndryshme me fakte alternative. Dhe kështu, mendoj se disa gjëra janë të implikuara këtu. Njëra është deteriorimi i gjatë i standardeve të jetesës dhe cilësisë së jetës, që ka filluar me 4 vitet e neoliberalizmit, të zhvendosjes së prodhimit, krijimin e ekonomisë së shërbimeve me paga të ulëta në vend të ekonomisë së pagës më të lartë familjare të prodhimit dhe kështu me radhë. Dhe pastaj roli i digjitalit është shumë i rëndësishëm për të treguar se ka një transformim struktural të sheshit publik dhe ka filluar me radion e djathtë, pastaj me Fox News dhe ITV, pastaj Facebook e të tjera. Ky është algoritmi që u jep të gjithëve saktësisht llojin e informacionit që ata tashmë kanë përbrendësuar. Pra, nëse e vendosni së bashku këtë deformim shumë strukturor të sheshit publik, së bashku me kushte të përkeqësuar jetese dhe pastaj shtoni një lloj geni të keq si Trump, keni një stuhi të përsosur. Ky është i gjithi problem i komunikimit politik i cili është thelbësor. Është kaq i copëzuar dhe kaq problematik. Nganjëherë është e vërtetë që idetë emancipatore qarkullojnë, por ato menjëherë ndezin një kundërpërgjigje historike. Dhe jo vetëm historike, por një kundërpërgjigje paranoike dhe të çmendur. "Njerëzit që punojnë me seksualitetin janë duke i mësuar fëmijët tanë të jenë queer", ose "njerëzit që punojnë për racizmin janë duke i infiltroara shkollat tona

me ide që janë krijuar për t'i bërë fëmijët e bardhë të ndihen fajtorë" dhe të tjera ide të tilla. Duket sikur jetojmë në një azil të çmendurish. Por përsëri, keni të drejtë që nuk kam punuar drejtpërdrejt shumë mbi aspektin digjital.

Jule Goikoetxea: Nuk mund të bësh gjithçka (buzëqesh). Pyetja ime e fundit ka të bëjë me socializmin. Si do të ishte ndryshe një demokraci socialiste nga demokracia liberale, për sa i përket ekonomisë ose prodhimit, ekologjisë, racës, familjes ose seksit, çfarëdo që keni imagjinuar?

Nancy Fraser: Së pari, për mua, socializmi dhe demokracia janë në të vërtetë të lidhura ngushtë. Disa njerëz kanë argumentuar që kapitalizmi dhe demokracia shkojnë bashkë, por kjo nuk ka qenë kurrë shumë bindëse. Dua të them se socializmi, në pikëpamjen time, është pikërisht shkatërrimi i kontrollit të drejtpërdrejtë demokratik që një shtresë e vogël e sipërmarrësve, investitorëve, aktorëve korporatë dhe aktorëve financiarë ushtrojnë mbi drejtimin themelor të zhvillimit shoqëror. Ata kontrollojnë tepricën shoqërore. Ata vendosin ta apropriojnë këtë në mënyrë private dhe e shpërndajnë sipas kalkulimeve të tyre se çfarë do të gjenerojë fitime të ardhshme. Me fjalë të tjera, shqetësimi i tyre i vetëm është kthimi i ulët i investimit. Dhe shumat e parave për të cilat po flasim janë kaq të mëdha, ato që përfaqësojnë në terma të energjisë njerëzore, punës njerëzore, aftësisë njerëzore janë kaq kolosale sa që esencialisht u kemi dhënë atyre licencë. Për të vendosur të ardhmen, nëse ka një të ardhme, sepse sinqerisht, ata po na çojnë drejt shkatërrimit të planetit. Por, nëse duhet të jap një pikë për atë që mendoj se është thelbi dhe shpirtit i socializmit, do të thosha kontrolli demokratik mbi tepricën

shoqërore. Ky është thelbi i saj. Jam gjithashtu për ofrimin shumë bujar në formën e mallrave publike për të kënaqur nevojat thelbësore. Por si e dini kjo është e njohur tashmë nga socialdemokracia. Ajo që është specifike për socializmin është kjo pyetje për riprodhimin e tepricës, për pronësinë tonë kolektive dhe ne duhet të vendosim në mënyrë demokratike përmes disa mekanizmave, por mos më pyetni se si. Duhet të organizojmë një proces të deliberatës dhe përfaqësimit dhe kështu me radhë përmes të cilit vendosim se çfarë të bëjmë me të ose madje nëse duam të kemi kaq shumë tepricë. Ndoshta duam të punojmë shumë më pak. Nuk mendoj se kjo është një mundësi në fillim, duke pasur parasysh sasinë masive të nevojave njerëzore të paplotësuara në të gjithë globin. Por mendoj se duhet të shohim dëmet masive që kapitalizmi ka lënë në natyrë. Pavarësisht gjithë bujës për sa produktiv është, në fakt është një makinë shkatërrimi dhe na ka lënë me shkatërrim të tmerrshëm në forma të ndryshme. Kështu që ndoshta kjo ide e kohës së lirë, që gjithmonë ka qenë një ideal socialist, nuk është në horizontin tonë të menjëhershëm, por në fund, pse nuk duhet të jetë një moment të caktuar? Dhe kështu, menjëherë, mendoj se po flasim për zgjerimin masiv të hapësirës. Cilat janë çështjet që janë çështje për drejtimin politik demokratik, siç janë proceset esencialisht të drejtuara nga tregu? Pra për mua, socializmi dhe demokracia shkojnë bashkë. Qëllimi nuk është thjesht për t'i bërë më demokratike, më gjithëpërfshirëse, më të barabarta ato hapësira të vogla që konsiderohen si hapësira demokratike. Qëllimi është të zgjerojmë shumë më shumë këto hapësira.

Jule Goikoetxea: Përmbyllje shumë e mirë. Shumë faleminderit, Nancy. Jam shumë mirënjohëse për kohën tuaj.

Nancy Fraser: Faleminderit shumë që e bëtë këtë intervistë. E di që bëni shumë punë e cila vlerësohet shumë, jam shumë mirënjohëse.

Jule Goikoetxea: Shumë faleminderit.

Nancy Fraser: Gjithë të mirat.


Kjo intervistë është bërë nga Jule Goikoetxea me Nancy Fraser.

Përkthyer në shqip nga Anita Vllahiu.

Skroni kodin më poshtë për të lexuar artikullin original në gjuhën angleze.



3



**PUNA EMOZIONALE
QË NUK PAGUHET
POR PRITET NGA
GRATË**

Gratë kryesisht mbajnë barrën e përgjegjësisë të padukshme në vendin e punës. Kjo punë është rraskapitëse dhe e pakompensuar.

Në vendet e punës anembanë botës, bëhen punë të cilat nuk janë pjesë e asnjë përshkrimi pune – dhe janë gratë ato të cilat e bëjnë pjesën më të madhe të tyre.

Puna emocionale është puna e pavlerësuar, shpesh e padukshme, e menaxhimit të ndjenjave të njerëzve të tjerë. “Nuk është vetëm puna ajo që udhëheq ekonomitë,” shpjegon Rose Hackman, autorja e një libri të vitit 2023 mbi këtë temë. “Është puna që udhëheq familjet dhe komunitetet. Puna emocionale është manipulimi i ndjenjave për të pasur efekt te klientët, konsumatorët, pasagjerët, pacientët. Është ajo që krijon një ndjenjë sigurie dhe lidhjeje, kuptim dhe përkatësi brenda një kompanie.”

Është thelbësore por edhe rraskapitëse, dhe shpeshherë e detyrueshme. Gratë mbajnë peshën më të madhe të kësaj. Fillimisht, ato dominojnë karriera që kërkojnë sasi të madhe pune emocionale. Por të gjitha vendet e punës kërkojnë një masë të kësaj, dhe veçanërisht në zyrat e dominuara nga burrat, gratë janë ato që kanë barrën kryesore, kryesisht pa mirënjohje apo shpërblim.

Që në moshë të re

Karrierat me punë intensive emocionale priren të jenë të dominuara nga gratë – për shembull fushat si infermieria, mësimdhënia, kujdesi për fëmijët, puna sociale dhe industria e shërbimeve të mikëpritjes. Edhe pse ekziston supozimi se gratë janë “të përshtatshme” për këto punë, Hackman thotë se në fakt ky është vetëm efekt i socializimit.

“Të gjitha tiparet, aftësitë dhe rolet që lidhen me punën emocionale u

janë vënë gjithmonë vajzave dhe grave, duke filluar nga një moshë shumë e re,” thotë ajo. “Vajzat nuk mësohen thjeshtë vetëm të jenë të ndjeshme ndaj të tjerëve, ato ndëshkohen nëse nuk janë.”

Është një lloj kondicionimi i përhapur, pajtohet E Michele Ramsey, një profesore e asociuar e studimeve të grave, gjinisë dhe seksualitetit në Penn State Berks, SHBA. “Ajo është pjesë e llojeve të lojërave ku priremi të socializohemi në lojë: vajzat e vogla luajnë me kukulla, mësuesen, infermieren. Djemtë luajnë lojëra shumë më aktive dhe më pak edukative.”

Ndikimi shtohet nga influenca të tjera gjatë fëmijërisë së hershme, shton ajo. “Kjo është përmirësuar disi, por në televizion ose në një libër që ju lexohet si fëmijë, kush është infermierja? Kush është mësuesi? Kush është shkencëtari dhe zjarrfikësi? Ato role shpesh janë shumë gjinore, dhe qysh nga fillimi, kjo kufizon atë që fëmijët mendojnë se janë opsionet e tyre.”

Por tipare si empatia dhe dhembshuria sigurisht që nuk janë tipare të lindura gjinore, dhe hulumtimet kanë treguar se nuk ka dallim kategorik midis trurit të burrave dhe grave. “Ka studime në të gjithë disiplinat akademike që tregojnë se empatia është një aftësi që të gjithë njerëzit, pavarësisht nga gjinia, janë në gjendje ta ushtrojnë,” thotë Hackman. “Por është barazuar aq shumë me të qenit vajzë apo grua, sa që ne nuk e shohim kondicionimin; ne e shohim atë se si janë vajzat dhe gratë në thelb.

“Shpesh është kondicionimi bazë i përbrendësuar , thotë Ramsey, ai që i shtyn gratë të zgjedhin karriera që kërkojnë punë dhe barrë të madhe emocionale.

“Nuk është për t’u habitur që më shumë gra marrin këto role edukative,” thotë ajo. “Njerëzit që janë të marginalizuar duhet të jenë më të mirë në komunikimin joverbal, ato duhet të jenë në gjendje të

lexojnë më mirë sinjalet, sepse duke qenë të shtypur, ato vazhdimisht duhet të kenë kujdes të mos shkelin në këmbët e askujt e të sigurohen që të mos thonë asgjë gabim. E gjithë kjo përbrendësohet në praktikimin e edukimit në të gjitha lojërat dhe të gjitha ndërveprimet tona. Pra nuk duhet të çuditemi kur njerëzit që identifikohen si gra zgjedhin punë të tilla.

Përtej ‘karrrierës për gratë’

Nuk janë vetëm punët si përkujdesja dhe pozicionet e shërbimit që kërkojnë punë emocionale – çdo vend pune e kërkon atë në njëfarë mase. Në përgjithësi, detyrat si planifikimi i festave, ditët e shërbimit dhe ushtrimet ekipore, mirëmbajtja e marrëdhënieve dhe ndërtimi i komunitetit, të gjitha u takojnë grave brenda vendeve të punës me gjini të përzier. Studimet tregojnë se gratë kryejnë shumë më shumë punë të kujdesit në zyrë – detyra që kryesisht asociohen me “promovueshmëri të ulët”.

Njëkohësisht, kjo ngarkesë e punës zakonisht nuk njihet dhe as shihet si punë shtesë dhe nuk i ndihmon gratë të ecin përpara. Megjithatë, nëse nuk e bëjnë, ato mund të lihen pas.

“Shumë gra që hyjnë në vende të punës të cilat më herët ishin të dominuara nga burrat, zbulojnë se prej tyre pritet, për shkak se janë gra, të ofrojnë një ndërrim shtesë të punës emocionale,” thotë Hackman. Hulumtimet kanë treguar se, veçanërisht në vendet e punës administrative apo të zyrës, ky ndërrim shtesë është një domosdoshmëri për gratë që ato të ecin përpara.

Një publikim në revistën *Menaxhimi i Burimeve Njerëzore* tregoi se burrat mund të përparonin duke qenë – dhe duke u dukur se janë – të mirë në punët e tyre, por që edhe gratë gjithashtu kishin nevojë për “orientim prosocial” .

“Në një firmë inxhinierike, për shembull, për të ecur përpara, një inxhinier burrë duhet të jetë dy gjëra: i sigurt dhe kompetent,” thotë Hackman. “Që një inxhinierë grua të ecë përpara, ajo duhet të shfaqë të njëjtat attribute, dhe më pas duhet të jetë gjithashtu e sjellshme dhe ngushëlluese si dhe bashkëpunëtoare në punën ekipore”.

Me fjalë të tjera, gratë gjithashtu duhet të jenë të sigurt dhe kompetente, plus të vëmendshme e të dhembshura. Por për ironi, përderisa gratë mbeten pas nëse nuk bëjnë punë shtesë, kjo as nuk i ndihmon shumë ato të ngjisin majat. “Të gjitha shërbimet shtesë që gratë kryejnë në punë – mbledhja e parave për arsye të ndryshme, planifikimi i ngjarjeve, kujtimi i datave të rëndësishme – nuk llogariten”, thotë Ramsey. “Kërkohej shumë organizim dhe shumë detyra; janë shumë aftësi solide në atë lloj pune. Por kur vjen koha për t’u promovuar, asnjë nga ato punë nuk bëhet pjesë e ekuacionit.”

Në fakt, një studim i vitit 2022 nga departamenti i psikologjisë në Universitetin e Nju Jorkut në Abu Dhabi dëshmoi se, ndërkohë që sjellja prosociale mund të rrisë mirëqenien e punonjësve, ajo gjithashtu mund t’i mbajë gratë jashtë roleve udhëheqëse duke shteruar kohën dhe burimet e grave të fuqishme pa shpërblime të barabarta dhe duke bërë të vështirë për gratë të legjitimojnë pushtetin e tyre.

Përveç që e bënë potencialisht më të vështirë avansimin, ka një kosto personale në kryerjen e gjithë kësaj pune shtesë. “Kostoja është shumë e madhe,” thotë Hackman. “Së pari, kjo thjeshtë konsumon kohë:

konsultimet me kolegët, të qenit bashkëpunëtorë në ekip, të qenit e pëlqyeshme, dërgimi i e-mailave. Gjithçka të merr kohë.”

Çështja e pagave

Gratë jo vetëm që nuk kompensohen për punën emocionale shtesë – dhe penalizohen nëse e shmangin atë – por analizat e hendekut gjinor të pagave gjithashtu tregojnë shpesh faktin se profesionet e dominuara nga gratë paguhën më pak në përgjithësi.

“Kjo është veçanërisht e vërtetë për punët e kujdesit, të tilla si punëtorët e kujdesit për fëmijët, punëtorët në shtëpi dhe ndihmëset shëndetësore në shtëpi, të gjitha paguhën me paga nën mesataren,” shkruajnë studiuesit në një raport të Departamentit të Punës të SHBA të vitit 2022 . “Dhe, përderisa kjo nuk kontribuon drejtpërdrejt në hendekun e pagave, punët e dominuara nga gratë gjithashtu kanë më pak gjasa të përfshijnë përfitime, si sigurimet shëndetësore të ofruara nga punëdhënësi dhe planet pensionale, në krahasim me profesionet e dominuara nga burrat.”

Kjo vazhdon, pavarësisht nga realiteti që këto punë të rënda emocionale ku gratë dominojnë, janë gjithashtu disa nga më të rëndësishmet.

“Pse ne i nënvlerësojmë këto lloj punësh, që janë ndoshta më thelbësoret në shoqërinë tonë dhe që nuk mund të zëvendësohen? Nuk mund të automatizoni sjelljen e mirë për pacientët apo prekjen njerëzore. Një pjesë e problemit është që ne nuk e shohim punën emocionale si punë,” thotë Hackman. Por në shumë role, veçanërisht në pozicionet e shërbimit për klientët dhe në punën e kujdesit, puna emocionale është thelbësore për punën që kryhet.

Kjo punë kërkon shumë organizim dhe shumë detyra; janë shumë aftësi solide në atë lloj pune. Por kur vjen koha për t'u promovuar, asnjë nga ato punë nuk bëhet pjesë e ekuacionit, thotë E Michele Ramsey

“Mendoni se çfarë do të ndodhte nëse kjo do të mungonte,” vazhdon ajo. “Nëse një përfaqësues i kujdesit ndaj klientit nuk kujdeset për problemin tuaj, kjo është e pasjellshme. Nëse ndihmësi i kujdesit shëndetësor në shtëpi që kujdeset për prindin tuaj të moshuar nuk përkushtohet të kujtojë ndonjë gjë ose të kontrollojë prindin, nëse asistenti i infermierisë është i ashpër, nëse shërbyesi në restorant ju nxiton, me siguri do të mendonit se të gjithë këta njerëz po bëjnë punë të tmerrshme.”

Ndërkohë, shumë gra mbeten të papaguara për punën e vështirë të kujdesit, edukimit dhe zgjidhjes së problemeve – një padrejtësi që justifikohet me idenë se vetë puna është shpërblimi i vërtetë.

“Ne shpërblehemi shoqërisht për këto tipare, por sistemi përfiton nga fakti që ne priremi ndaj këtyre roleve,” thotë Hackman. “Nga ne, supozohet që t'i shohim këto punë si përmbushëse në vetvete, përtej pagës. Nuk do ta prisnim kurrë këtë në një fushë tradicionalisht të dominuar nga burrat. Nuk do të thonim kurrë, ‘oh, burrat janë më të mirë në matematikë, kështu që nëse je bankier, puna duhet të jetë mjaft shpërblyese dhe nuk ke nevojë për një pagë të mirë’. Por kjo është mënyra se si ne inkurajojmë gratë të hyjnë në këto industri. Është e pabesueshme që ne jemi rehat duke u nën-paguar për punë nga të cilat shoqëria varet për të plotësuar nevojat thelbësore”.

Vlera e vërtetë e ‘punës së grave’

Hapi i parë për t'i dhënë më shumë vlerë punës emocionale të grave

mund të jetë njohja e thjeshtë se ajo është, në fakt, punë. “Ne kemi nevojë për ndryshim normativ,” thotë Hackman. “Ne duhet të vlerësojmë tiparet si kujdesi për të tjerët dhe empatia në punë. Mos e trajtoni këtë lloj pune si një grup tiparësh të caktuara, por si diçka që kërkon kohë, përpjekje dhe aftësi.”

Gjërat po ecin, sado ngadalë, në atë drejtim. Aftësitë sociale dhe ndërpersonale po fitojnë rëndësi për të gjitha gjinitë me rritjen e numrit të vendeve të punës që kërkojnë ndërveprim të lartë social (vetëm në SHBA, pjesa e fuqisë punëtore të roleve të tilla u rrit me 12% në 30 vitet e fundit).

Vlerësimi i aftësive të punës emocionale – duke e përfshirë atë në përshkrimet e punës dhe si një aspekt më formal të vlerësimit të punëtorëve, dhe duke gjetur mënyra më konkrete për ta shpërblyer atë – mund të ndihmojë në shpërndarjen e barrës së saj në mënyrë më të barabartë midis punonjësve, në vend që kjo t’u lihet vetëm grave.

Ramsey tërheq vërejtjen se, përderisa njohja dhe vlerësimi i punës shtesë të grave është një gjë e mirë, ajo gjithashtu mund të ketë pasoja potenciale për sa i përket rritjes së pritshmërive: megjithëse mund të duket kundërintuitive, thotë ajo, vlerësimi më i madh i punës mund të rrisë presionin ndaj grave për të bërë edhe më shumë punë. “Shpesh është si dy hapa përpara, një hap prapa,” thotë ajo. “Kur ndodhin gjëra që një farë mënyre lehtësojnë presionin ndaj grave, atëherë standardet papritmas rriten dhe presioni kthehet përsëri.”

Në fund të fundit, Hackman thotë se gratë duhet të kompensohen për këtë ndërrim shtesë. “Ne jetojmë në një botë që thotë se nëse krijoni vlerë në treg, shpërbleheni për të. E vërteta është se ka shumë njerëz që krijojnë shumë vlera që nuk shpërblehen.”

Ky artikulli është shkruar nga Kate Morgan.

Përkthyer në shqip nga Blerton Ajeti.

Skanoji kodin më poshtë për të lexuar artikullin origjinal në gjuhën angleze.



4

**PUNËVE TË
SHTËPISË
PO JU VJEN FUNDI**

**NJË PERSPEKTIVË E
KLASËS PUNËTORE**



Punët e shumta si gatimi, larja e enëve dhe rrobave, rregullimi i shtretërve, pastrimi, blerjet etj., që me një emër të përbashkët i quajmë punë të shtëpisë, marrin mesatarisht tre deri në katër mijë orë brenda vitit të një amviseje të zakonshme. Sado tronditëse të duket kjo statistikë, ajo as që përfshin vëmendjen e vazhdueshme, e të pamatshme, që nënat duhet t'u kushtojnë fëmijëve të tyre. Ashtu siç merren gjithmonë si të mirëqena detyrat e saj si nënë, edhe puna e saj e pafund si amvise rrallëherë vlerësohet brenda familjes. Punët e shtëpisë, në fund të fundit, janë pothuajse të padukshme: askush nuk i vëren ato derisa të mos jenë kryer – ne vëmë re shtratin e pashtruar, por jo dyshtemenë e larë dhe të lustruar. E padukshme, e përsëritur, rraskapitëse, joproductive, aspak kreative - janë mbiemrat që më së miri përshkruajnë natyrën e punëve të shtëpisë.

Ndërgjegjësimi i ri që lidhet me lëvizjen bashkëkohore të grave po inkurajon një numër gjithnjë e më të madh grash të kërkojnë nga partnerët e tyre burra lehtësim nga kjo barrë e lodhshme. Tashmë, shumë burra kanë filluar të ndihmojnë partneret e tyre në punët e shtëpisë, madje disa prej tyre u kushtojnë kohë të barabartë këtyre punëve. Por sa prej këtyre burrave janë çliruar nga ideja se punët e shtëpisë janë “punë të grave”? Sa prej tyre nuk do ta përshkruanin përfshirjen e tyre në pastrimin e shtëpisë si “ndihmë” për partneret e tyre?

Nëse do të ishte e mundur që njëkohësisht të zhbëhej ideja se punët e shtëpisë janë “punë të grave” dhe ato të ndaheshin në mënyrë të barabartë mes burrave dhe grave, a do të përbënte kjo një zgjidhje të kënaqshme? Derisa shumica e grave me dëshirë do të mirëpritnin ardhjen e “amvisit”, deseksualizimi i punëve të shtëpisë nuk do të ndryshonte realisht natyrën shtypëse të këtyre punëve. Përfundimisht

as gratë e as burrat nuk duhet të harxhojnë orë të çmuara të jetës së tyre, duke u marrë me një punë, që nuk është as stimuluese dhe as produktive.

Një nga sekretet më të mbrojtura të shoqërive të avancuara kapitaliste lidhet me mundësinë - mundësinë reale - të transformimit radikal të natyrës së punëve të shtëpisë. Një pjesë e konsiderueshme e punëve të shtëpisë së një amviseje mund të integrohet në ekonominë industriale. Me fjalë të tjera, punët e shtëpisë nuk kanë pse të konsiderohen më domosdoshmërisht dhe pandryshueshëm si përgjegjësi private. Ekipet e trajnuara dhe të paguara mirë, që lëvizin nga një banesë te tjetra, duke përdorur pajisje pastrimi teknologjikisht të avancuara, mund t'i kryejnë shpejt dhe me efikasitet punët që një amvise e sotme i bën me vështirësi dhe në mënyrë primitive. Pse ka heshtje kaq të thellë rreth potencialit për të ripërcaktuar në mënyrë radikale natyrën e punëve të shtëpisë? Sepse ekonomia kapitaliste është strukturalisht armiqësore ndaj industrializimit të punëve të shtëpisë. Socializimi i punëve të shtëpisë do të nënkuptonte subvencione të mëdha nga qeveria për të garantuar qasje për familjet e klasës punëtore, të cilat kanë më së shumti nevojë për këto shërbime. Meqenëse kjo do të prodhonte pak fitim, industrializimi i punëve të shtëpisë - si çdo ndërmarrje jofitimprurëse - është i papranueshëm për ekonominë kapitaliste. Megjithatë, zgjerimi i shpejtë i forcës punëtore të grave do të thotë se çdoherë e më shumë gratë do ta kenë më të vështirë të shkëlqejnë si amvise sipas standardeve tradicionale. Me fjalë të tjera, industrializimi dhe socializimi i punëve të shtëpisë po shndërrohen në një nevojë objektive shoqërore. Punëve të shtëpisë, si një përgjegjësi individuale dhe private e grave dhe si një punë e feminizuar që kryhet në kushte teknike primitive, mund të jetë duke ju ardhë fundi.

Megjithëse punët e shtëpisë, siç i njohim sot, me kalimin e kohës

mund të mbeten një relikë e së kaluarës, qëndrimet mbizotëruese shoqërore vazhdojnë ta lidhin gjendjen e përrjetshme femërore me imazhet e fshesave dhe tenxhereve, leckave dhe kovave, përparëseve dhe shporetëve. Është po ashtu e vërtetë që puna e grave, nga një epokë historike në tjetrën, është lidhur përgjithësisht me shtëpinë. Megjithatë, puna e grave në shtëpi nuk ka qenë gjithmonë ajo që është sot, sepse, si të gjitha fenomenet shoqërore, punët e shtëpisë janë një produkt i ndryshueshëm i historisë njerëzore. Përderisa sistemet ekonomike janë ngritur dhe kanë rënë, natyra dhe cilësia e punëve të shtëpisë kanë pësuar transformime të mëdha.

Siç argumenton Friedrich Engels në veprën e tij klasike “Origjina e Familjes, Pronës Private dhe Shtetit”, pabarazia gjinore, siç e njohim sot, nuk ekzistonte para shfaqjes së pronës private. Gjatë epokave të hershme të historisë njerëzore, ndarja gjinore e punës brenda sistemit të prodhimit ekonomik ishte komplementare dhe jo hierarkike. Në shoqëritë ku burrat ishin përgjegjës për gjuetinë e kafshëve të egra dhe gratë nga ana tjetër, për mbledhjen e perimeve dhe frutave të egra, të dyja gjinitë kryenin funksione ekonomike të cilat ishin njësoj të rëndësishme për mbijetesën e komunitetit. Për shkak se komuniteti, gjatë atyre epokave, ishte kryesisht familja e gjerë, roli qendror i grave në çështjet e shtëpisë bënte që ato të ishin anëtare të vlerësuara e të respektuara të komunitetit.

Përqendrimi i obligimeve të grave në shtëpi në kulturat para-kapitaliste u dramatizua përmes një përvoje personale gjatë një udhëtimi me xhip që bëra në vitin 1973 nëpër Rrafshnaltën Masai. Në një rrugë të izoluar në Tanzani, vura re gjashtë gra Masai që balanconin në mënyrë enigmatike një dërrasë të madhe mbi kokat e tyre. Miqtë e mi nga Tanzania më shpjeguan se ato gra me gjasë po transportonin një çati shtëpie drejt një fshati të ri, i cili ishte duke u

ndërtuar. Siç mësova, ndër Masai-t, gratë janë përgjegjëse për të gjitha aktivitetet shtëpiake, përfshirë edhe ndërtimin e shtëpive të lëvizshme të popullit të tyre nomad. Punët e shtëpisë për gratë Masai nuk përfshijnë vetëm gatimin, pastrimin, rritjen e fëmijëve dhe qepjen, por edhe ndërtimin e shtëpive. Sado të rëndësishme të jenë aktivitetet e burrave me blegtorinë, “punët shtëpiake” të grave janë po aq produktive e thelbësore sa edhe kontributet ekonomike të burrave Masai.

Në ekonominë nomade para-kapitaliste të Masai-ve, puna e grave në shtëpi është po aq thelbësore për ekonominë sa dhe punët e rritjes së bagëtive që kryejnë burrat e tyre. Si prodhuese, gratë gëzojnë status të rëndësishëm shoqëror që korrespondon me rolin ekonomik të tyre. Në të kundërt, në shoqëritë e avancuara kapitaliste, puna e shtëpisë e orientuar kah shërbimi, që gratë rrallëherë mund të vërtetojnë me prova të prekshme, përgjithësisht zvogëlon statusin shoqëror të grave. Në fund të fundit, sipas ideologjisë borgjeze, amvisja shihet thjeshtë si shërbëtoare e përjetshme e burrit të saj.

Origjina e konceptit borgjez për gruan si shërbëtoare e përjetshme e burrit është histori domethënëse në vete. Brenda historisë relativisht të shkurtër të Shteteve të Bashkuara, figura e amvises si një produkt historik i përfunduar, është prezente në fare pak më gjatë se një shekull. Gjatë epokës koloniale, puna e shtëpisë ishte krejtësisht ndryshe nga ajo që është sot punë e përditshme e një amviseje në ShBA.

“Puna e një gruaje fillonte me lindjen e diellit dhe vazhdonte nën dritën e zjarrit, për aq kohë sa ajo mund të mbante sytë hapur. Për dy shekuj, pothuajse gjithçka që familja përdorte, apo hante, prodhohej në shtëpi nën drejtimin e saj. Ajo tjerre dhe ngjyrose fijen që e kthente në pëlhurë dhe pastaj e priste dhe e qepte me dorë në veshje.

Ajo kultivonte një pjesë të madhe të ushqimit që familja e saj konsumonte dhe ruante mjaftueshëm për të kaluar muajt e dimrit. Ajo prodhonte gjalpë, djathë, bukë, qirinj dhe sapun dhe thurte çorapet e familjes së saj.”

Në ekonominë bujqësore para-industriale të Amerikës së Veriut, gruaja që kryente punët e shtëpisë ishte tjerresë, thurëse e rrobaqepëse, si dhe bukëpjekëse, prodhuese gjalpi, qirinjsh e sapuni. Dhe lista vazhdon, etj., etj., etj. Në fakt, “presionet e prodhimit në shtëpi linin shumë pak kohë për detyrat që sot do i njohim si punë të shtëpisë. Sipas të gjitha përshkrimeve, gratë para Revolucionit Industrial do të ishin amvise të ngathëta sipas standardeve të sotme. Në vend të pastrimit të përditshëm ose javor, ekzistonte pastrimi pranveror. Shujtat ishin të thjeshta e të përsëritura; rrobat ndërroheshin rrallë; dhe larja e rrobave lejohej të grumbullohej, duke u bërë një herë në muaj, apo në disa familje një herë në tre muaj. Dhe, sigurisht, meqenëse çdo larje kërkonte bartjen dhe ngrohjen e shumë kovave me ujë, standardet e larta të pastërtisë binin lehtësisht.”

Gratë koloniale nuk ishin pastrueset apo kujdestaret e shtëpive, por punëtore të vërteta e të afta në kuadër të ekonomisë me bazë në shtëpi. Përveç që prodhonin shumicën e produkteve që u nevojiteshin familjeve të tyre, ato gjithashtu kujdeseshin edhe për shëndetin e familjeve dhe komuniteteve të tyre.

“Ishte përgjegjësia e gruas koloniale të mblidhte dhe thante bimët e egra që përdoren... si ilaçe; ajo shërbente gjithashtu si mjeke, infermiere dhe mami brenda familjes së saj dhe komunitetit.”

Në librin popullor me receta koloniale, United States Practical Recipe Book, përveç recetave për ushqime, përfshihen edhe receta për kimikate shtëpiake dhe ilaçe. Për shembull, për të kuruar infeksionin kërpudhor të lëkurës, “merrni pak ‘rrënjë gjaku’...copëtojeni, vendos-

-eni në uthull, dhe me lëngun e fituar shpërlajeni vendin e infektuar”. Rëndësia ekonomike e funksioneve të grave në shtëpi, në Amerikën koloniale, plotësohej nga rolet e tyre të dukshme në aktivitetet ekonomike jashtë shtëpisë. Për shembull, ishte krejtësisht e pranueshme që një grua të ishte pronare tavernash.

“Gratë po ashtu drejtonin fabrika druri dhe mullinj, thurnin karrige të kallamit dhe ndërtonin orendi, udhëhiqnin thertore, shtypnin pambuk dhe pëlhura të tjera, bënë dantella dhe zotëronin apo menaxhonin dyqane mallrash të thata dhe veshjesh. Ato punonin në dyqane duhani, farmaci (ku shisnin përzierjet që i përgatisnin vetë) dhe dyqane të përgjithshme që ofronin gjithçka, nga gjilpërat deri te peshoret për mish. Gratë bluanin xhamat për syze, rregullonin krehrat për lesh dhe madje lyenin shtëpitë. Shpeshherë, ato ishin edhe varrmihëset e qytetit...”

Rritja e industrializimit pas revolucionit, çoi në shumimin e fabrikave në pjesën verilindore të vendit të ri. Kombinatet e tekstit të New England ishin pionierët e suksesshëm të sistemit të fabrikave. Meqenëse tjerja dhe thurja ishin punë tradicionale të grave në shtëpi, ato ishin punëtoret e para që u rekrutuan nga pronarët e mullinjve, për të operuar me vegjët e ri të fuqisë. Duke pasur parasysh përjashtimin e mëvonshëm të grave nga prodhimi industrial në përgjithësi, është domethënëse që disa nga punëtoret e para industriale ishin gra.

Me avancimin e industrializimit, i cili zhvendosi prodhimin ekonomik nga shtëpia në fabrikë, rëndësia e punës në shtëpi të grave pësoi një erozion sistematik. Gratë humbën në dy aspekte: ndërsa punët e tyre tradicionale u uzurpuan nga fabrikat që po shtoheshin, e gjithë ekonomia u largua nga shtëpia, duke i lënë shumë gra kryesisht pa role të rëndësishme ekonomike. Nga mesi i shekullit të nëntëmbë-

-dhjetë, fabrikat po prodhonin tekstil, qirinj dhe sapun. Madje edhe gjalpi, buka dhe produkte të tjera ushqimore filluan të prodhoheshin në masë.

Deri në fund të shekullit, pothuajse askush më nuk prodhonte vetë niseshtenë as nuk zienin rrobat nëpër kazane. Në qytete, gratë blinin të gatshme bukën dhe të brendshmet, dërgonin fëmijët në shkollë dhe ndoshta lanin disa rroba jashtë shtëpisë, dhe diskutonin përparësitë e ushqimeve të konservuara. Rrjedha e industrisë kishte tejkaluar, duke lënë të papërdorura vegun në papafingo dhe kazanin e sapunit në depo.

Me konsolidimin e kapitalizmit industrial, ndarja midis sferës së re ekonomike dhe ekonomisë tradicionale të shtëpisë u bë gjithnjë e më rigoroze. Zhvendosja fizike e prodhimit ekonomik, e shkaktuar nga përhapja e sistemit të fabrikave, përfaqësonte padyshim një transformim drastik. Por edhe më radikal ishte rivlerësimi i përgjithshëm i prodhimit, i imponuar nga sistemi i ri ekonomik. Ndërsa mallrat e prodhuara në shtëpi ishin të vlefshme kryesisht sepse plotësonin nevojat bazë të familjes, rëndësia e produkteve të prodhuara në fabrika qëndronte kryesisht në vlerën e tyre të shkëmbimit - aftësinë për të plotësuar kërkesat e punëdhënësve për fitim. Ky rivlerësim i prodhimit ekonomik dëshmoi - përtej ndarjes fizike midis shtëpisë dhe fabrikës - një ndarje strukturore të thellë midis ekonomisë me bazë në shtëpi dhe ekonomisë kapitaliste, të orientuar drejt fitimit. Meqenëse punët e shtëpisë nuk gjenerojnë fitim, kjo formë e punës u përcaktua natyrshëm si formë inferiore e punës, krahasuar me punën kapitaliste me pagë. Një nënprodukt ideologjik i rëndësishëm i këtij transformimi radikal ekonomik ishte lindja e konceptit të “amvises.” Gratë filluan të riformuloheshin ideologjikisht si kujdestare të jetës së zhvlerësuar shtëpiake. Si ideologji

megjithatë, ky riformulim i rolit të grave kundërshtojë hapur nga numri i madh i grave emigrante që mbushnin radhët e klasës punëtore në verilindje. Këto emigrante të bardha ishin punëtore me pagë para se të ishin amvise. Për më tepër, kishte miliona gra të tjera që ishin të detyruara të punonin larg shtëpisë, si prodhuese në ekonominë skllavopronare të jugut. Realiteti i rolit të grave në shoqërinë e shekullit XIX në Shtetet e Bashkuara përfshinte gra të bardha, ditët e të cilave kalonin duke drejtuar makineri fabrikash për paga minimale, po aq sa përfshinte gratë zezake që punonin nën detyrimin e skllavërisë. “Amvisja” reflektonte një realitet të pjesshëm, pasi ajo ishte në të vërtetë simbol i prosperitetit ekonomik që shijohej nga klasat e mesme në zhvillim.

Megjithëse koncepti i “amvise” ishte rrënjësor në kushtet shoqërore të borgjezisë dhe klasës së mesme, ideologjia e shekullit XIX e vendosi amvisen dhe nënën si modele universale të gruas. Duke qenë se propaganda popullore përfaqëonte misionin e grave si një funksion i roleve të tyre në shtëpi, gratë që detyroheshin të punonin për paga filluan të trajtoheshin si vizitore të huaja brenda botës mashkullore të ekonomisë publike. Duke dalë jashtë “sferës së tyre natyrore”, gratë nuk u trajtuan si punëtore me pagë të plotë. Çmimi që ato paguan përfshinte orë të gjata pune, kushte pune nën çdo standard dhe paga jashtëzakonisht të ulëta. Shfrytëzimi i tyre ishte edhe më i madh se ai i burrave. Pa dyshim, seksizmi u shfaq si një burim fitimesh të jashtëzakonshme për kapitalistët.

Ndarja strukturore, midis ekonomisë publike kapitaliste dhe ekonomisë private të shtëpisë, është përforcuar vazhdimisht nga primitivizmi këmbëngulës i punëve të shtëpisë. Pavarësisht përhapjes së pajisjeve për përdorim shtëpiak, puna e shtëpisë ka mbetur cilësisht e pandryshuar nga përparimet teknologjike që burojnë nga kapitali-

-zmi industrial. Punët shtëpiake ende zënë mijëra orë në vitin mesatar të një amviseje. Në vitin 1903, Charlotte Perkins Gilman propozoi një përkufizim të punës së shtëpisë, që pasqyronte ndryshimet e mëdha që kishin transformuar strukturën dhe përmbajtjen e punëve të shtëpisë, në Shtetet e Bashkuara:

“... Termi ‘punë të shtëpisë’ nuk i referohet një lloji të veçantë pune, por një niveli të caktuar pune, një gjendjeje zhvillimi nëpër të cilën kalojnë të gjitha llojet e punës. Të gjitha industritë dikur ishin ‘shtëpiake,’ domethënë kryheshin në shtëpi dhe në interes të familjes. Të gjitha industritë që nga ajo periudhë e largët janë ngritur në nivele më të larta, përveç një ose dy prej tyre, të cilat nuk e kanë dalë kurrë nga faza fillestare.”

“Shtëpia,” pohon Gilman, “nuk është zhvilluar në përpjesëtim me institucionet e tjera.” Ekonomia e shtëpisë zbulon:“... ruajtjen e industrive primitive në një komunitet modern industrial dhe kufizimin e grave në këto industri dhe në një hapësirë të kufizuar shprehjeje.”

Gilman thekson se puna e shtëpisë cënon humanitetin e grave: “Ajo është femërore, më shumë se sa që duhet, ashtu si burri është mashkullor, më shumë se sa që duhet; por ajo nuk është njerëzore aq sa ai është njerëzor. Jeta në shtëpi nuk nxjerr në pah humanitetin tonë, sepse të gjitha linjat dalluese të progresit njerëzor gjenden jashtë saj.”

Vërtetësia e pohimit të Gilman-it mbështetet nga përvoja historike e grave zezake në Shtetet e Bashkuara. Gjatë gjithë historisë së këtij vendi, shumica e zezakeve kanë punuar jashtë shtëpive të tyre. Gjatë periudhës së skllavërisë, gratë punonin krah për krah me burrat e tyre në fushat e pambukut dhe duhanit. Kur industria filloi të zhvillohej në jug, ato u punësuan në fabrika duhani, rafineri sheqeri, madje

edhe në mulli druri, dhe grupe punëtorësh që rrihnin çelikon për hekurudha. Në punë, gratë skllave ishin të barabarta me burrat e tyre. Për shkak të kësaj barazie të lodhshme gjinore në punë, ato gëzonin një barazi më të madhe gjinore edhe në kushte shtëpiake, në banesat e skllëverve, krahasuar me motrat e tyre të bardha, të cilat ishin “amvise.”

Si pasojë e drejtpërdrejtë e punës së tyre jashtë shtëpisë – si gra “të lira” po aq sa si skllave – puna e shtëpisë nuk ka qenë kurrë fokusi kryesor i jetës së grave zezake. Ato i kanë shpëtuar në masë të madhe dëmeve psikologjike që kapitalizmi industrial i shkaktoi amviseve të bardha të klasës së mesme, virtytet e supozuara të të cilave ishin dobësia femërore dhe nënshtrimi bashkëshortor. Gratë zezake se mund të synonin dobësinë; ato duhej të bëheshin të forta, sepse familjet dhe komunitetet e tyre kishin nevojë për forcën e tyre për të mbijetuar. Dëshmia e forcave të grumbulluara që zezaket kanë formuar me punë, punë dhe më shumë punë, mund të shihet në kontributet e shumë lidereve të shquara gra që kanë dalë nga komuniteti i tyre. Harriet Tubman, Sojourner Truth, Ida Wells dhe Rosa Parks nuk janë gra zezake të jashtëzakonshme, aq sa janë epitome të feminitetit të zezakeve.

Zezaket, megjithatë, kanë paguar një çmim të rëndë për fuqinë që kanë fituar dhe për pavarësinë relative që kanë shijuar. Edhe pse rrallëherë kanë qenë “thjesht amvise,” ato gjithmonë kanë kryer punët e shtëpisë. Kështu, ato kanë mbajtur barrën e dyfishtë të punës me pagë dhe punëve të shtëpisë – një barrë që gjithmonë kërkon që gratë punëtore të zotërojnë fuqinë këmbëngulëse të Sizifit. Siç thekson W. E. B. DuBois në vitin 1920: “... disa gra lindin të lira, dhe disa arrijnë lirinë mes fyerjeve dhe stigmave; por grave tona zezake iu imponua liria përçmuese. Me atë liri, ato po blejnë një pavarësi të pakufizuar

dhe, sado i shtrenjtë të jetë çmimi që po paguajnë për të, në fund të fundit do të vlejë çdo tallje dhe psherëtimë.”

Ashtu si burrat e tyre, gratë zezake kanë punuar derisa nuk kanë pasur më fuqi. Ashtu si burrat e tyre, ato kanë marrë përsipër përgjegjësitë e sigurimit të jetesës për familjen. Cilësitë femërore joortodokse si vendosmëria dhe vetëbesimi – për të cilat zezaket shpesh janë lavdëruar, por edhe më shpesh qortuar – pasqyrojnë punën dhe betejat e tyre jashtë shtëpisë. Por, ashtu si motrat e tyre të bardha të quajtura “amvise,” ato kanë gatuar dhe pastruar, janë kujdesur dhe kanë rritur një numër të pafund fëmijësh. Ndryshe nga amviset e bardha, të cilat mësuan të mbështeteshin te burrat e tyre për siguri ekonomike, gratë dhe nënat zezake, që zakonisht ishin edhe punëtore, rrallëherë kanë pasur kohë dhe energji për t’u bërë eksperte në punët e shtëpisë. Ashtu si motrat e tyre të bardha të klasës punëtore, të cilat gjithashtu bartin barrën e dyfishtë të punës për mbijetesë dhe shërbimit ndaj burrave dhe fëmijëve, gratë zezake kanë pasur nevojë për lehtësim nga kjo shtypje për një kohë shumë të gjatë.

Mungesa, në mos mungesa e plotë, e diskutimit publik mbi mundësinë e transformimit të punëve të shtëpisë në një përgjegjësi sociale, dëshmon fuqinë verbëruese të ideologjisë borgjeze. Nuk është se roli shtëpiak i grave nuk ka marrë fare vëmendje, përkundrazi, lëvizja bashkëkohore e grave e ka pasqyruar punën e shtëpisë si një përbërës thelbësor të shtypjes së grave. Madje, ekziston edhe një lëvizje në disa vende kapitaliste, shqetësimi kryesor i së cilës është gjendja e amvises. Duke arritur në përfundimin se puna e shtëpisë është poshtëruese dhe shtypëse kryesisht sepse është një punë e papaguar, kjo lëvizje ka ngritur kërkesën për pagë. Një pagesë javore nga qeveria,

argumentojnë aktivistët, është çelësi për të përmirësuar statusin e amvises dhe pozicionin shoqëror të grave në përgjithësi.

Lëvizja Paga për Punët e Shtëpisë e ka origjinën në Itali, ku në mars të vitit 1974 u mbajt demonstrata e saj e parë publike.

Duke iu drejtuar turmës së mbledhur në qytetin Mestre, një nga folëset tha: “Gjysma e popullsisë së botës është e papaguar – ky është kontrasti më i madh klasor! Dhe kjo është lufta jonë për paga për punët e shtëpisë. Kjo është kërkesa strategjike; në këtë moment, është kërkesa më revolucionare për të gjithë klasën punëtore. Nëse ne fitojmë, fiton klasa; nëse ne humbasim, humbet klasa.”

Sipas strategjisë së kësaj lëvizjeje, pagat janë çelësi i emancipimit të amviseve, dhe vetë kërkesa për paga përfaqëson fokusin qendror të fushatës për çlirimin e grave në përgjithësi. Për më tepër, lufta e amviseve për paga projektohet si çështja kryesore e të gjithë lëvizjes së klasës punëtore.

Origjina teorike e Lëvizjes Paga për Punët e Shtëpisë mund të gjendet në një ese të Mariarosa Dalla Costa me titullin “Gratë dhe Nënshtrimi i Komunitetit”. Në këtë shkrim, Dalla Costa argumenton për riformulimin e konceptit të punëve të shtëpisë, duke u bazuar në tezën e saj se karakteri privat i shërbimeve të shtëpisë, është në fakt iluzion. Ajo këmbëngul se amvisja duket sikur u shërben vetëm nevojave private të burrit dhe fëmijëve të saj, por përfituesit e vërtetë të shërbimeve të saj janë punëdhënësi aktual i burrit të saj dhe punëdhënësit e ardhshëm të fëmijëve të saj.

“(Gruaja) është izoluar në shtëpi, e detyruar të kryejë punë që konsiderohet e pakualifikuar: puna e lindjes, rritjes, disiplinimit dhe shërbimit për punëtorin që merr pjesë në prodhim. Roli i saj në ciklin e prodhimit ka mbetur i padukshëm, sepse vetëm produkti i punës së saj, punëtori, ishte i dukshëm.”

Kërkesa që amviset të paguhen, bazohet në supozimin se ato prodhojnë një mall po aq të rëndësishëm dhe të vlefshëm, sa mallrat që prodhojnë burrat e tyre në punë. Duke ndjekur logjikën e Dalla Costa-s, Lëvizja Paga për Punët e Shtëpisë i përcakton amviset si krijuese të fuqisë punëtore, e cila shitet nga anëtarët e familjes së tyre si mall në tregun kapitalist.

Dalla Costa nuk ishte teoricienja e parë që propozoi një analizë të tillë të shtypjes së grave. Si Mary Inman në veprën e saj “Në Mbrojtje të Grave” (1940) ashtu edhe Margaret Benston në artikullin “Ekonomia Politike e Çlirimit të Grave” (1969), e definojnë punën e shtëpisë në një mënyrë që i vendos gratë në një klasë të veçantë punëtoresh të shfrytëzuara nga kapitalizmi, të quajtura “amvise.” Nuk mund të mohohet se rolet e grave në riprodhim, rritjen e fëmijëve dhe mirëmbajtjen e shtëpisë e bëjnë të mundur që anëtarët e familjes së tyre të punojnë – të shkëmbejnë fuqinë e tyre punëtore për paga. Por, a nënkupton automatikisht se gratë në përgjithësi, pavarësisht nga klasa dhe raca e tyre, mund të përcaktohen në mënyrë themelore nga funksionet e tyre brenda shtëpisë? A nënkupton automatikisht se amvisja është në të vërtetë një punëtore e fshehtë brenda procesit të prodhimit kapitalist?

Nëse Revolucioni Industrial rezultoi në ndarjen strukturore të ekonomisë së shtëpisë nga ekonomia publike, atëherë puna e shtëpisë nuk mund të përcaktohet si një komponent i pandashëm i prodhimit kapitalist. Përkundrazi, ajo lidhet me prodhimin si një parakusht. Punëdhënësi nuk është aspak i preokupuar për mënyrën se si fuqia punëtore prodhohet dhe mbështetet; atij i intereson vetëm disponueshmëria e saj dhe aftësia për të gjeneruar fitim. Me fjalë të tjera, procesi kapitalist i prodhimit presupozon ekzistencën e një fuqie punëtorësh të shfrytëzueshëm.

“Ripërtëritja e fuqisë punëtore (punëtorëve) nuk është pjesë e procesit të prodhimit shoqëror, por parakusht i tij. Ai ndodh jashtë procesit të punës. Funkzioni i tij është mirëmbajtja e ekzistencës njerëzore, e cila është qëllimi përfundimtar i prodhimit në të gjitha shoqëritë.”

Në shoqërinë e Afrikës së Jugut, ku racizmi ka çuar shfrytëzimin ekonomik në kufijtë e tij më brutal, ekonomia kapitaliste e shfaq ndarjen e saj strukturore nga jeta shtëpiake në një mënyrë karakteristike, të dhunshme. Arkitektët shoqërorë të aparteidit kanë përcaktuar thjeshtë, se puna e zezakëve sjell fitime më të larta, kur jeta shtëpiake pothuajse braktiset tërësisht. Burrat zezakë shihen si njësi pune, potenciali prodhues i të cilëve, i bën ata të vlefshëm për klasën kapitaliste. Por gratë dhe fëmijët e tyre ”... janë shtojca të tepërta – jo-produktive, gratë që nuk janë asgjë më shumë se plotësuese të aftësisë riprodhuese të njësisë punëtore të burrave zezakë.”

Ky përshkrim i grave afrikane si “shtojca të tepërta” nuk është aspak metaforë. Në përputhje me ligjin e Afrikës së Jugut, gratë zezake të papunësuar janë të ndaluara të qëndrojnë në zonat e njerëzve të bardhë (87 për qind të vendit!), madje, në shumicën e rasteve, edhe në qytetet ku burrat e tyre jetojnë dhe punojnë.

Jeta shtëpiake e zezakëve në qendrat industriale të Afrikës së Jugut shihet nga mbështetësit e aparteidit si e panevojshme dhe jofitimprurëse. Por gjithashtu shihet edhe si kërcënim.

“Zyrtarët qeveritarë e njohin rolin e grave në krijimin e një shtëpie dhe kanë frikë se prania e tyre në qytete, do të çojë në krijimin e një popullsie të qëndrueshme zezake.”

Konsolidimi i familjeve afrikane në qytetet e industrializuara perceptohet si kërcënim, sepse jeta shtëpiake mund të shërbejë si bazë

për një nivel më të lartë të rezistencës ndaj apartheidit. Kjo është padyshim arsyeja pse një numër i madh grash, që kanë leje banimi për zonat e bardha, dërgohen për të jetuar në konvikte të ndara sipas gjinisë. Si gratë e martuara, ashtu edhe ato beqare, përfundojnë duke jetuar në këto ndërtesa.

Në këto konvikte, jeta familjare është rreptësisht e ndaluar – burrat dhe gratë nuk mund të vizitojnë njëri-tjetrin, dhe as nëna e as babai nuk mund të vizitohen nga fëmijët e tyre.

Ky sulm i ashpër ndaj grave zezake në Afrikën e Jugut veçse ka filluar të shfaqë pasoja, pasi vetëm 28.2% e tyre aktualisht zgjedhin që të martohen. Për arsye të leverdisë ekonomike dhe sigurisë politike, apartheidi po gërryen – me synimin e dukshëm për të shkatërruar – vetë strukturën e jetës në shtëpi të zezakëve. Kapitalizmi në Afrikën e Jugut demonstroi hapur shkallën në të cilën ekonomia kapitaliste varet në mënyrë absolute nga punët e shtëpisë.

Shkatërrimi i qëllimshëm i jetës familjare në Afrikën e Jugut nuk mund të ishte ndërmarrë nga qeveria, nëse vërtet shërbimet e kryera nga gratë në shtëpi do të ishin përbërës thelbësor i punës me pagë në kapitalizëm. Fakti që jeta shtëpiake mund të eliminohet nga versioni i kapitalizmit në Afrikën e Jugut, është pasojë e ndarjes mes ekonomisë private të shtëpisë, dhe procesit publik të prodhimit, që karakterizon shoqërinë kapitaliste në përgjithësi. Dukshëm, është e kotë të argumentohet se, bazuar në logjikën e brendshme të kapitalizmit, gratë duhet të paguhet për punët e shtëpisë.

Nëse supozojmë se teoria që qëndron në themel të kërkesës për paga është thellësisht e gabuar, a mund të jetë megjithatë politikisht e dëshirueshme të këmbëngulet, që amviset të paguhet? A nuk mund të përdoret një imperativ moral për të mbrojtur të drejtën e grave për t'u paguar për orët që i kushtojnë punëve të shtëpisë? Ideja e një page

për amviset ndoshta do të tingëllonte tërheqëse për shumë gra. Por kjo tërheqje ka gjasa të jetë jetëshkurtër. Sa prej atyre grave do të ishin realisht të gatshme të pajtoheshin me detyrat e lodhshme e të pafundme të shtëpisë, vetëm për hir të një page? A do ta ndryshonte një pagë faktin që, siç ka thënë Lenini, ”... punët e vogla të shtëpisë e shtypin, e mbysin, e mpijnë dhe e poshtërojnë (gruan), e lidhin atë pas kuzhinës dhe dhomës së fëmijëve dhe e shpërdorojnë punën e saj në një lodhje barbarisht joproduktive, të parëndësishme, rraskapitëse, mpirëse dhe shtypëse.”

Do të dukej sikur pagat e qeverisë për amviset do të legjitimonin më tej këtë skllavëri shtëpiake.

A nuk përbën një kritikë të nënkuptueshme ndaj Lëvizjes Paga për Punët e Shtëpisë fakti që gratë që marrin ndihmë sociale rrallëherë kanë kërkuar kompensim për mirëmbajtjen e shtëpisë? Jo “paga për punët e shtëpisë,” por më tepër “të ardhura vjetore të garantuara për të gjithë” është slogani që artikulon alternativën e menjëhershme që kanë propozuar ndaj sistemit çnjerëzues të mirëqenies. Ajo që ato kërkojnë në plan afatgjatë, megjithatë, janë vende pune dhe sisteme publike të përballueshme për kujdesin ndaj fëmijëve. Të ardhurat vjetore të garantuara shërbejnë, pra, si një sigurim papunësie, deri në krijimin e më shumë vendeve të punës me paga adekuate, krahas sistemeve të subvencionuara të kujdesit për fëmijët.

Përvojat e një grupi tjetër të grave shfaqin natyrën problematike të strategjisë “paga për punët e shtëpisë.” Pastrueset, punëtoret në shtëpi, shërbëtoret - janë gratë që e dinë më mirë se kushdo, çfarë do të thotë të marrësh pagë për punët e shtëpisë. Situata e tyre tragjike është përshkruar në mënyrë brilante në filmin e Ousman Sembene me titull *La Noire de...* Personazhi kryesor është një grua e re senegaleze e cila, duke kërkuar punë, bëhet dado për një familje franceze që jeton

në Dakar. Kur familja kthehet në Francë, ajo i bashkohet me plot entuziazëm. Megjithatë, sapo arrin në Francë, kupton se përveçse për fëmijët, tash ajo është përgjegjëse edhe për gatimin, pastrimin, larjen dhe të gjitha punët e tjera të shtëpisë. Nuk kalon shumë kohë, dhe entuziazmi me të cilin e nisi, shndërrohet në depresion - në depresion aq të thellë, saqë ajo refuzon pagën që i ofrojnë punëdhënësit e saj. Paga nuk mund të kompensojë situatën skllavëruese në të cilën gjendet. Duke mos pasur mjete për t'u kthyer në Senegal, ajo ndihet aq e mposhtur nga dëshpërimi, sa zgjedh vetëvrasjen, në vend që të përballlet me një fat të pacaktuar të gatimit, fshirjes, pluhurosjes dhe pastrimit...

Në Shtetet e Bashkuara, gratë me ngjyrë - veçanërisht gratë zezake - kanë marrë paga për punët e shtëpisë për dekada të tëra. Në vitin 1910, kur më shumë se gjysma e të gjitha grave zezake punonin jashtë shtëpive të tyre, një e treta e tyre ishin të punësuar si punëtore me pagesë në shtëpi. Deri në vitin 1920, më shumë se gjysma ishin shërbëtoresh, dhe në vitin 1930, kjo përqindje ishte rritur në tre nga pesë gra. Një nga pasojat e ndryshimeve të mëdha në punësimin e grave gjatë Luftës së Dytë Botërore, ishte një rënie e mirëpritur në numrin e punëtoreve shtëpiake zezake. Megjithatë, në vitin 1960, një e treta e të gjitha grave zezake, që kishin punë, ishin ende të kufizuara në profesionet e tyre tradicionale. Vetëm kur punët administrative u bënë më të qasshme për gratë zezake, përqindja e punëtoreve në shtëpi filloi të bjerë në mënyrë të dukshme. Sot, kjo shifër sillet rreth 13%.

Detyrimet rraskapitëse të punëve të shtëpisë për gratë në përgjithësi, janë dëshmi flagrante të fuqisë së seksizmit. Për shkak të ndërhyrjes shtesë të racizmit, një numër i madh i grave zezake janë detyruar jo vetëm të kujdesen për punët e shtëpisë së tyre, por edhe për punët e

shtëpive të grave të tjera. Shpesh, kërkesat e punës në shtëpinë e një gruaje të bardhë i kanë detyruar punëtorët të neglizhojnë shtëpinë e madje edhe fëmijët e tyre. Si pastruese me pagesë, ato janë thirrur të jenë bashkëshorte dhe nëna zëvendësuese në miliona shtëpi të bardha. Gjatë më shumë se pesëdhjetë viteve të përpjekjeve për organizim, punëtorët e shtëpisë kanë tentuar të ripërcaktojnë punën e tyre, duke refuzuar rolin e amvisës surrogate. Detyrat e amvisës janë të pafundme e të papërcaktuara. Punëtorët e shtëpisë kanë kërkuar, në radhë të parë, përcaktim të qartë të detyrave që pritet të kryejnë. Vetë emri i një prej sindikatave kryesore të punëtorëve të shtëpisë sot – Household Technicians of America – thekson refuzimin e tyre për të funksionuar si amvisë surrogate, puna e të cilave përshkruhet thjesht si “punë shtëpie.” Për sa kohë që punëtorët e shtëpisë qëndrojnë në hijen e amvisës, ato do të vazhdojnë të marrin paga që janë më afër “shpenzimit të lejuar mujor” të një amviseje, sesa një page të mirëfilltë punëtori. Sipas Komitetit Kombëtar për Punësimin në Familje, në vitin 1976 një punëtorë shtëpie me kohë të plotë fitonte mesatarisht 2,732\$, ndërsa dy të tretat e tyre fitonin më pak se 2,000\$. Megjithatë disa vite më parë punëtorët e shtëpisë ishin përfshirë në mbrojtjen e ligjit për pagën minimale, në vitin 1976 një përqindje tronditëse prej 40% ende merrte paga jashtëzakonisht nën standard. Lëvizja Paga për Punët e Shtëpisë supozon se, nëse gratë do të paguheshin për të qenë amvisë, ato do të gëzonin status më të lartë shoqëror. Megjithatë, një histori krejtësisht ndryshe na tregojnë sfidat e vazhdueshme të punëtorëve të shtëpisë me pagë, kushtet e të cilave janë më të mjerueshme se ato të çfarëdo grupi tjetër punëtorësh nën kapitalizëm. Më shumë se 50% e grave në ShBA sot punojnë për të siguruar jetesën dhe ato përbëjnë 41% të fuqisë punëtorë të vendit. Megjithatë, një numër i madh i grave aktualisht nuk mund të gjejnë vende punë të

denja. Ashtu si racizmi, edhe seksizmi është një nga justifikimet kryesore për shkallët e larta të papunësisë së grave. Shumë gra janë “thjesht amvise” sepse realisht janë punëtore të papuna. A nuk mundet, pra, që roli i “thjesht amvise” të sfidohet më efektivisht, duke kërkuar vende pune për gratë në nivel të barabartë me burrat, dhe duke kërkuar shërbime sociale (p.sh. kujdes për fëmijët) dhe përfitime tjera (si pushimin e lehonisë), të cilat do të lejojnë më shumë gra të punojnë jashtë shtëpisë?

Lëvizja Paga për Punët e Shtëpisë i dekurajon gratë nga kërkimi i punës jashtë shtëpisë, duke argumentuar se “skllavëria në një linjë prodhimi, nuk është çlirim nga skllavëria në lavamanin e kuzhinës”. Megjithatë, përkrahëset e fushatës këmbëngulin se nuk mbrojnë burgosjen e vazhdueshme të grave brenda mjedisit të izoluar të shtëpive të tyre. Ato deklarojnë se, ndonëse refuzojnë të punojnë në tregun kapitalist si të tillë, nuk dëshirojnë që gratë të kenë përgjegjësinë e përhershme për punët e shtëpisë. Siç shprehet një përfaqësuese amerikane e kësaj lëvizjeje: “... nuk jemi të interesuara ta bëjmë punën tonë më efikase apo më produktive për kapitalin. Jemi të interesuara ta reduktojmë punën tonë dhe, në fund, ta refuzojmë atë plotësisht. Por, për aq kohë sa punojmë në shtëpi pa pagë, askush nuk shqetësohet se sa gjatë apo sa shumë punojmë. Kapitali përdor teknologji të avancuar për të ulur kostot e prodhimit, vetëm pas rritjes së pagave nga klasa punëtore. Vetëm nëse e bëjmë punën tonë të kushtueshme (do të thotë vetëm nëse e bëjmë të pafavorshme ekonomikisht), kapitali do të “zbulojë” teknologjinë për ta reduktuar atë. Aktualisht, shpesh na duhet të punojmë një turn të dytë pune, në mënyrë që të përballojmë enëlarësen që supozohet të shkurtojë punët tona të shtëpisë.”

Pasi gratë të kenë fituar të drejtën për t'u paguar për punën e tyre, ato mund të kërkojnë paga më të larta, duke i detyruar kapitalistët të ndër marrin industrializimin e punëve të shtëpisë. A është kjo strategji konkrete për çlirimin e grave apo një ëndërr e perealizueshme?

Si supozohet që gratë të nisin luftën për paga? Dalla Costa propozon që amviset të hyjnë në grevë: “Ne duhet të refuzojmë shtëpinë, sepse duam të bashkohemi me gratë e tjera, për të luftuar kundër çdo varianti që supozon se gratë do të qëndrojnë në shtëpi... Braktisja e shtëpisë është një formë e luftës, meqë shërbimet shoqërore që kryejmë atje, nuk do të vazhdojnë të realizohen më në ato kushte.”

Por, ku do të shkojnë gratë nëse lënë shtëpitë,? Si do të bashkohen me gratë e tjera? A do të jetë dëshira për t'u revoltuar kundër punëve të shtëpisë e vetmja arsye për të cilën ato do të lënë shtëpitë? A s'do të ishte më realiste, që t'u bëjmë thirrje grave që të “braktisin shtëpitë” në kërkim të vendeve të punës jashtë, ose të paktën, që të marrin pjesë në një fushatë masive për vende të dinjitetshme të punës? Sigurisht, puna në kushtet kapitaliste është punë brutale. Sigurisht, është jokreative dhe tjetërsuese. Megjithatë, pavarësisht nga këto, mbetet fakt që në vendin e punës, gratë mund të bashkohen me motrat – dhe vëllezërit – e tyre për të sfiduar kapitalistët, pikërisht aty ku ndodh prodhimi. Si punëtore, si aktiviste militante në lëvizjen sindikaliste, gratë mund të gjenerojnë fuqinë e vërtetë, për të luftuar shtyllën mbështetëse dhe përfituesin kryesor të seksizmit, që është sistemi monopolist kapitalist.

Strategjia e pagave për punët e shtëpisë bën pak për të ofruar një zgjidhje afatgjate për shtypjen e grave, dhe nuk trajton në mënyrë të ndjeshme pakënaqësinë e thellë të amviseve bashkëkohore. Studimet e fundit sociologjike kanë zbuluar se sot amviset janë më të frustrura se kurrë më parë me jetët e tyre. Kur Ann Oakley realizoi intervistat për

librin e saj “The Sociology of Housework”, ajo zbuloi se, edhe amviset që fillimisht dukeshin të pashqetësuar nga punët e shtëpisë, në fund shprehnin një pakënaqësi të thellë. Këto janë fjalët e një gruaje që punonte në një fabrikë: “(A ju pëlqejnë punët e shtëpisë?) Nuk më shqetëson... Besoj se mua nuk më shqetëson puna e shtëpisë, sepse nuk e bëj gjatë gjithë ditës. Unë shkoj në punë dhe merrem me punët e shtëpisë vetëm gjysmën e ditës. Po ta bëja gjithë ditën, nuk do ta pëlqeja – puna e grave nuk mbaron kurrë, ato janë gjithmonë në lëvizje – edhe para se të shtrihesh për të fjetur, ke ende diçka për të bërë – shkundja e shpuzoreve, larja e disa filxhanëve. Je ende duke punuar. Është e njëjta gjë çdo ditë; nuk mund të thuash që nuk do ta bësh, sepse duhet ta bësh – si përgatitja e një shujte: duhet ta bësh, sepse nëse nuk e bën, fëmijët nuk do të hanë... Mendoj se thjesht mësohesh, i bën automatikisht... Unë jam më e lumtur në punë sesa në shtëpi.”

“(Cilat mendoni se janë anët më të këqija të të qenit amvise?) Mendoj se ka ditë kur ndihesh sikur zgjohesh dhe duhet të bësh të njëjtat gjëra të zakonshme – mërzitësh nga monotonia, ke ngecur në të njëjtën rutinë. Mendoj se nëse pyet ndonjë amvise, nëse janë të sinqerta, do të përgjigjen e do të thonë, se gjysmën e kohës ndihen si skllave - të gjitha e mendojnë këtë kur ngrihen në mëngjes: ‘Oh jo, edhe sot do të bëj të njëjtat gjëra, deri sa të flejë.’ Është përsëritja e të njëjtave gjëra – monotonia.”

A do ta pakësonin pagat këtë monotoni? Kjo grua me siguri do të thoshte jo. Një amvise me kohë të plotë i tregoi Oakley-t për natyrën detyruese të punëve të shtëpisë: “Gjëja më e keqe është që duhet ta bësh punën sepse je në shtëpi. Edhe pse kam mundësinë të mos e bëj, nuk mendoj se do të mundesha vërtet të mos e bëja, sepse ndjem sikur duhet ta bëj.”

Me shumë gjasë, paga për këtë punë do ta përkeqësonte obsesionin e kësaj gruaje.

Oakley arriti në përfundimin se puna e shtëpisë, veçanërisht kur është me kohë të plotë, pushton aq thellë personalitetin e grave, sa që amvisja bëhet e pandashme nga puna e saj. “Amvisja, në një kuptim të rëndësishëm, është puna e saj: për këtë arsye dallimi i elementeve subjektive dhe objektive, në këtë situatë bëhet shumë më i vështirë.”

Pasoja psikologjike shpesh është një personalitet tragjikisht i shtypur, i përndjekur nga ndjenja e inferioritetit. Çlirimi psikologjik vështirë se mund të arrihet thjesht me një pagë për amvisen.

Studime të tjera sociologjike kanë konfirmuar zhgënjimin e thellë që përjetojnë amviset bashkëkohore. Kur Myra Ferree intervistoi mbi 100 gra të një komuniteti punëtorësh pranë Bostonit, “pothuajse dyfish më shumë amvise sesa gra të punësuar shprehën pakënaqësi me jetën e tyre.” Pa dyshim, shumica e grave që punonin nuk kishin punë që i vetpërmbushnin: ato ishin kamariere, punëtore fabrikash, daktilografe, shitëse në supermarkete dhe dyqane, etj. Megjithatë, mundësia për të dalë nga izolimi i shtëpive të tyre, për të “dalë jashtë dhe për të parë njerëz të tjerë,” për to ishte po aq e rëndësishme sa të ardhurat që fitonin. A do të mirëprisnin amviset, të cilat ndiheshin sikur “po çmendeshin duke qëndruar në shtëpi,” idenë e marrjes së pagës për të çmendur veten? Një grua ankohej se “qëndrimi në shtëpi gjatë gjithë ditës është si të jesh në burg” – a do t’i rrëzonin muret e këtij burgu pagat? Arratisja e vetme realiste nga ky burg është kërkimi i një pune jashtë shtëpisë.

Secila prej më shumë se 50% të grave në ShBA që punojnë, janë argument i fuqishëm për lehtësimin e barrës së punëve të shtëpisë. Në fakt, ndërmarrësit kapitalistë tashmë kanë filluar të shfrytëzojnë nevojën historike të grave për t’u çliruar nga rolet e tyre si amvise.

Rrjetet e pafundme fitimprurëse të ushqimeve të shpejta, si McDonald's dhe Kentucky Fried Chicken, dëshmojnë faktin se më shumë gra në punë do të thotë më pak shujta të përgatitura në shtëpi. Pavarësisht shijes dhe mungesës së vlerave ushqyese të ushqimit, pavarësisht shfrytëzimit të punëtorëve të tyre, opsionet e ushqimeve të shpejta vënë në pah se punëve të shtëpisë po u vjen fund. Na duhen, natyrisht, institucione të reja sociale për të marrë përsipër një pjesë të mirë të detyrave të dikurshme të amviseve. Kjo është sfida që buron nga radhët në rritje të grave të klasës punëtore. Kërkesa për kujdes universal dhe të subvencionuar për fëmijët, është pasojë e drejtpërdrejtë e rritjes së numrit të nënave që punojnë. Përderisa më shumë gra organizohen rreth kërkesës për më shumë vende pune mbi bazën e barazisë së plotë me burrat, gjithnjë e më shumë do të shtrohen pyetje serioze për qëndrueshmërinë e ardhshme të punëve të amviseve. Mund të jetë e vërtetë që “skllavëria në një linjë prodhimi” nuk është domosdoshmërisht “çlirim nga lavamani i kuzhinës,” por linja e prodhimit është padyshim nxitësi më i fuqishëm për gratë, që të kërkojnë eliminimin e skllavërisë së lashtë shtëpiake.

Shfuqizimi i punëve të shtëpisë, si përgjegjësi private dhe individuale e grave, është qartësisht një qëllim strategjik i çlirimit të grave. Por, socializimi i punëve të shtëpisë - përfshirë përgatitjen e shujtave dhe kujdesin për fëmijët - presupozon fundin e sundimit të motivit të profitit mbi ekonominë. Hapat e vetëm të rëndësishëm drejt fundit të skllavërisë shtëpiake, në fakt, janë ndërmarrë në vendet socialiste ekzistuese. Pra, gratë punëtore kanë interes të veçantë e jetik në luftën për socializëm. Për më tepër, nën kapitalizëm, fushatat për vende pune, me kushte të barabarta me burrat, kombinuar me lëvizje për institucione si kujdesi shëndetësor publik i subvencionuar, mbartin një potencial revolucionar shpërthyes. Kjo strategji vë në pikëpyetje

vlefshmërinë e kapitalizmit monopolist dhe, në fund të fundit, do të na drejtojë drejt socializmit.

Ky tekst është kapitulli i 13-të i shkëputur nga libri “Gratë, Raca dhe Klasa” i Angela Davis (1981).

Përkthyer në shqip nga Blenda Asllani.

Skanoji kodin më poshtë për të lexuar artikullin origjinal në gjuhën angleze.



5

PSE BURRAT

NUK E

SHFRYTËZOJNË

PUSHIMIN E

ATËSISË?

Pushimi i atësisë, i cili ka përfitime të shumta, po ofrohet më shumë se kurrë më parë. Por, pse nuk po e shfrytëzojnë këtë burrat?

Në verën e vitit 2018, Ricardo Duque ishte gati të fillonte pushimin pesë mujor të atësisë nga kompania e arkitekturës në Londër, ku ai punonte. Por, atëherë, gjyshja e tij në Portugalinë jugore u sëmur nga pneumonia.

Gruaja e Duque-s, e cila është indiane, sapo kishte rifilluar punën në Samsung, pas shtatë muajsh pushim të lehonisë. “Mezi gjeja kohë për vajzën tonë”, kujton 42-vjeçari. “Por nuk kisha zgjidhje. E dërgova në Portugali dhe kalova javët në vijim duke u kujdesur për fëmijën tim të vogël dhe gjyshen time, me shumë pak ndihmë nga dikush tjetër.”

Që nga momenti që Duque dhe gruaja e tij zbuluan se po prisnin një fëmijë, ai e dinte se donte të shfrytëzonte pushimin e atësisë, gjë me të cilën pajtohej edhe partnerja e tij. Pavarësisht se ishte i shqetësuar se po merrte “shikime” nga kolegët dhe se po “gjykohej nga menaxherët” kur i informoi për planin e tij – dhe megjithëse pushimi i tij nuk filloi tamam siç ishte parashikuar – përvoja e tij ishte jashtëzakonisht e mirë. “Koha që kaluam së bashku ishte tepër e çmuar dhe nuk do ta ndërroja për asgjë”, thotë ai. “Tani kemi një lidhje shumë të veçantë.”

Në Mbretërinë e Bashkuar, SHBA dhe shumë pjesë tjera të botës, baballarët që e shfrytëzojnë lejen prindërore, ende përbëjnë një pakicë të vogël. Numri i vendeve ku pushimi i atësisë është i paraparë me ligj është dyfishuar në 20 vitet e fundit (rreth 90 vende); dhe globalisht, të paktën katër në çdo 10 organizata mendohet se ofrojnë leje me pagesë mbi minimumin ligjor. Megjithatë, përqindja e burrave që marrin më shumë se disa ditë pushim nga puna kur fëmija i tyre lind, është ende i vogël.

Sa i përket arsyeve për të mos marrë pushim, shumica e baballarëve përmendin frikën e diskriminimit në vend të punës, humbjen e

mundësive të ngritjes në karrierë, marginalizimin, apo edhe talljen nga kolegët. Akademikët i konsiderojnë këto shqetësime rezultat i stereotipeve të dëmshme gjinore dhe që janë të rrënjosura thellë. Ata sugjerojnë se për të ndryshuar këtë duhen ndryshime të mëdha kulturore, si dhe ofertë më të mirë institucionale të pushimit të atësisë me pagesë.

Stereotipet e përbrendësuara

Thekla Morgenroth, hulumtuese në Psikologjinë Sociale dhe Organizative në Universitetin e Exeter, MB, thotë se stereotipet gjinore vazhdojnë të ekzistojnë, edhe pse rolet gjinore në punë kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore në dekadat e fundit, me një numër shumë më të lartë të grave që hyjnë dhe qëndrojnë në fuqinë punëtore.

“Gratë nuk shihen domosdoshmërisht si më pak kompetente se burrat, por gratë vazhdojnë të shihen si më të shoqërueshme, të ngrohta, edukuese dhe që përkujdesen më shumë sesa burrat, dhe shihen si më të përshtatshme për role që kërkojnë këto vlera dhe attribute, si kujdesi ndaj fëmijëve” shpjegon ajo – “Burrat, në anën tjetër, vazhdojnë të shihen si më vendimtar, të sigurt, konkurrues”. “Burrat që marrin leje prindërore mund të përballen me reagime negative dhe të shihen si të dobët, me mungesë angazhimi në punë”, shton Thekla Morgenroth.

Kjo, thotë Morgenroth, mund të ndikojë në vendimet në lidhje me lejen prindërore në shumë mënyra. “Së pari, gratë dhe burrat mund t’i përvetësojnë dhe përbrendësojnë këto stereotipe, që do të thotë se burrat mund të mendojnë se nuk janë shumë të shoqërueshëm dhe kështu, nuk do të ishin shumë të mirë në kujdesin e fëmijëve. Shpesh,

edhe partneret e tyre gra mund të përforcojnë stereotipet gjinore të përbrendësuarra dhe të dekurajojnë partnerët e tyre burra që të marrin leje prindërore, sepse nuk mendojnë se janë të aftë.”

Një faktor kyç është se stereotipet gjinore nuk janë vetëm përshkruese, por edhe urdhëruese; ato sinjalizojnë se si duhet të jenë gratë dhe burrat – duke përfshirë idenë që burrat duhet t'i japin përparësi punës mbi familjen.

“Burrat që marrin leje prindërore mund të përballen me reagime negative dhe të shihen si të dobët, me mungesë angazhimi në punë e kështu me radhë, gjë që mund të rezultojë në pasoja në punë, si ulja në detyrë etj.”, thotë ajo. “Burrat janë të vetëdijshëm për këto pasoja të mundshme, dhe kjo mund të kontribuojë përfundimisht që ata të vendosin kundër marrjes së pushimit prindëror, edhe nëse u ofrohet.”

Pa modele frymëzuese

Komunikimi është një faktor i rëndësishëm që Sarah Forbes, pedagoge dhe studiuese akademike në Shkollën e Biznesit të Universitetit të Birminghamit, e identifikon si një sfidë tjetër të padukshme për burrat për të shfrytëzuar pushim e atësisë.

Në vitin 2015, Mbretëria e Bashkuar prezantoi një politikë të përbashkët të pushimit prindëror që u lejon prindërve të ndajnë deri në 50 javë pushim dhe deri në 37 javë të paguara në mes tyre. Por, hulumtimi në vitin 2018, tregoi se nga më shumë se 900,000 prindër në Mbretërinë e Bashkuar që kishin të drejtë të përfitonin nga kjo politikë, vetëm 9,200 prindër – ose rreth 1% – e bënë këtë.

Ricardo Duque thotë se kjo mund të jetë pjesërisht si rezultat i faktit që shumë baballarë nuk i njohin të drejtat e tyre. “Kur morra lejen e atësisë, u trondita nga fakti se sa pak baballarë të tjerë e dinin se çfarë

të drejta kishin”, thotë ai.

Forbes beson se është e rëndësishme të kesh “kampionë të atësisë” të dukshëm në kompani, nëpër pozita dhe departamente të ndryshme, si për të frymëzuar baballarët për të marrë leje prindërore, ashtu edhe për të përmirësuar njohuritë e tyre për dispozitat ekzistuese. “Gjithashtu, nëse menaxherët kanë njohuri për mundësinë e organizatës rreth pushimit të atësisë dhe pushimit të përbashkët prindëror, kjo do të rezultojë në vetëdije më të lartë të prindërve për të drejtat e tyre.”

Thekla Morgenroth gjithashtu konsideron që shembujt kanë rëndësi të madhe. “Nëse burra të tjerë përdorin pushimin prindëror në një kompani të caktuar, kjo tregon se marrja e lejes prindërore është normale dhe e pranueshme për burrat,” shpjegon ajo. “Këto efekte janë edhe më të dukshme kur burrat në pozita drejtuese përdorin pushimin prindëror, sepse ata mund të veprojnë si shembuj dhe të demonstrojnë se mund të jesh i suksesshëm edhe nëse e shfrytëzon pushimin prindëror.”

Megjithatë, për fat të keq, hulumtimet tregojnë se pikërisht burrat në pozita vendim-marrëse, priren të marrin më pak pushim. Hulumtimet e kryera në Gjermani, Austri dhe Zvicër në vitin 2017 treguan se baballarët pa përgjegjësi profesionale drejtuese kishin shumë më shumë gjasa të shfrytëzonin pushim prindëror sesa bashkëmoshatarët e tyre që ishin menaxherë.

“Kjo duhet të ndryshojë,” thotë Morgenroth. “Sigurisht që është mirë nëse kompanitë ofrojnë leje prindërore me pagesë për baballarët, dhe absolutisht se duhet, por për sa kohë që udhëheqësit nuk tregojnë se burrat nuk do të penalizohen nëse shfrytëzojnë këtë pushim, gjërat nuk do të ndryshojnë shumë.”

Norma të pathëna

Ekspertët po paralajmërojnë se pasiguria e madhe e krijuar nga pandemia Covid-19, veçanërisht ankthi rreth sigurisë për vendin e punës, kanë përkeqësuar shqetësimet e punëtorëve për përdorimin e kohës së lirë.

Në një sondazh me mbi 500 baballarë amerikanë të kryer në maj, rreth dy të tretat e të anketuarve pranuan se ekzistonte një rregull i pashkruar që burrat nuk duhet të shfrytëzojnë lejen e plotë të atësisë – dhe se shfrytëzimi i sa më pak ditëve nga pushimi i atësisë, ishte “një simbol nderi”.

Nëntëdhjetë përqind e të anketuarve raportuan se punëdhënësi i tyre u ofroi më pak se 12 javë pushim të atësisë, por pothuajse dy të tretat thanë se planifikonin të shfrytëzonin më pak se gjysmën e kësaj. Pesëdhjetë e tetë përqind pranuan se kishin frikë se shfrytëzimi i plotë i pushimit të atësisë do ta dëmtonte karrierën e tyre.

Në SHBA, megjithëse kompanitë individuale ofrojnë leje të atësisë, baballarët nuk kanë të drejtë ligjore për asnjë leje prindërore me pagesë. Në fakt, SHBA-ja është një nga vendet e pakta pa asnjë pushim prindëror, as pushim lehonie. Presidenti Joe Biden ka planifikuar të zgjerojë pushimin prindëror përmes Planit për Familjet Amerikane, por nuk është aspak e qartë nëse legjislacioni do të aprovohet.

Në muajt e fundit, përgjegjësitë që lidhen me sektorin e kujdesit kanë bërë që miliona gra të lënë punën, si dhe shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore të grave në SHBA ra në nivelin e saj më të ulët që nga viti 1988. Normat gjinore duket se janë bërë edhe më të rrënjosura nga pandemia – diçka që, e kombinuar me paqëndrueshmërinë e vazhdueshme ekonomike, mund ta bëjë edhe më të vështirë për baballarët që duan pushim.

Përparësitë e pavlerësuara

Shumë akademikë thonë se ajo që është veçanërisht zhgënjyese në lidhje me shfrytëzimin e ulët të lejes së atësisë, është potenciali që ky pushim ka për të reduktuar hendekun gjinor të pagave. “Pabarazia gjinore do të vazhdojë në vendin e punës për aq kohë sa prindërimi në vitet e hershme shihet kryesisht si punë e grave”, thotë Emma Banister, profesore në Institutin e Punës dhe Barazive të Universitetit të Mançesterit. “Kwadri i tanishëm ligjor nuk e sfidon këtë mjaftueshëm.”

Hulumtimet kanë nxjerrë në pah edhe avantazhe të tjera të rëndësishme të shfrytëzimit të pushimit të atësisë. Një studim i botuar në vitin 2019 tregoi se edhe nëntë vjet më vonë, fëmijët, baballarët e të cilëve morën të paktën dy javë pushim të atësisë, raportuan se ndjeheshin më afër baballarëve të tyre sesa fëmijët me baballarë që nuk kanë pasur leje të atësisë. Një studim tjetër zbuloi se tek çiftet e martuara heteroseksuale, kur baballarët marrin pushim atësie, ulen gjasat e divorcit deri në gjashtë vjet pas lindjes.

Disa vende kanë bërë përparime kur bëhet fjalë për burrat që marrin më shumë leje prindërore. Suedia u ofron prindërve 480 ditë leje prindërore me pagesë për secilin fëmijë, që ata kanë të drejtë ta ndajnë. Secili prind mund t’i transferojë një pjesë të lejes së tij tjetrit, por 90 ditë duhet të rezervohen posaçërisht për secilin prind. Nga viti 2008 deri në vitin 2017, si një nxitje për baballarët për të shfrytëzuar më shumë pushim prindëror, familjet kishin të drejtën e një bonusi financiar të përcaktuar nga numri i ditëve të ndara në mënyrë të barabartë midis prindërve.

Politika duket se po funksionon: Një studim në vitin 2019 tregoi se afërsisht 90% e baballarëve suedezë përdorin pushimin e atësisë, dhe se

mesatarisht, ata përdorin 96% të sasisë totale të kohës së pushimit që u është caktuar. Suedia është gjithashtu lidere në mesin e ekonomive të zhvilluara për sa i përket pjesëmarrjes së grave në tregun e punës.

Në mbështetje të një shoqërie më të barabartë

Megjithatë, në mungesë të legjislacionit gjithëpërfshirës, Banister beson se punëdhënësit duhet të reduktojnë barrierat për shfrytëzimin e lejes së atësisë duke “normalizuar punonjësit që marrin leje gjatë vitit të parë të lindjes ose adoptimit të fëmijës së tyre, pavarësisht nga gjinia ose orientimi seksual i punonjësve”.

Ka edhe gjëra më specifike që duhet marrë në konsideratë, si koha kur përdoret pushimi. Pushimi prindëror i subvencionuar nga kompania, nëse ofrohet, shpesh kufizohet vetëm në muajt e parë – kur mund t’u përshtatet më shumë nënave gjidhënëse. Nëse punëdhënësit do t’u jepnin të gjithë prindërve një pagë të mirë për çdo periudhë kohore të pushimit prindëror, pavarësisht se kur e marrin atë (plus një periudhë të pushimit të atësisë të paguar plotësisht rreth kohës së lindjes), kjo do t’u jepte prindërve më shumë fleksibilitet.

Por idealisht, thotë Banister, pushimi i atësisë dhe mbështetja financiare për këtë pushim duhet të jetë përgjegjësi e shtetit, sepse vendosja e përgjegjësisë mbi punëdhënësit – siç është rasti në SHBA – mund të çojë në një “sistem me dy nivele” ku vetëm disa sektorë ofrojnë lejen e atësisë.

Në fund të fundit, duket se heqja e sfidave që i pengojnë baballarët nga përdorimi i pushimit të atësisë, fillon me një pushim të ofruar në mënyrë të duhur dhe të komunikuar mirë, që më pas mund të fillojë të ulë stereotipet gjinore dhe të normalizojë këtë praktikë.

“Qeveria duhet të ofrojë një pako minimale të përshtatshme që inkurajon sjelljet që mbështesin një shoqëri më të barabartë gjinore,” thotë Banister.

Ky artikulli është shkruar nga Josie Cox.

Përkthyer në shqip nga Donjeta Morina.

Skani kodin më poshtë për të lexuar artikullin original në gjuhën angleze.



6

ZONJA

SHEFE MA

JELL NJË KAFE



Në minutat e fundit të një pasditeje të së premtes, erdhi një kërkesë nga një klient drejtuar kompanisë konsulente të mirënjohur. E para që vullnetarisht e ofroi kohën, ishte menaxherja grua. Ajo, tashmë kishte kaluar gjithë ditën duke u takuar me kolegët e saj të rinj, të cilët kishin nevojë për këshillime në karrierë, edhe pse nuk ishin pjesë e ekipit të saj. Në fillim të javës kishte trajnuar disa nga të rekrutuarit e rinj, kishte ndihmuar një koleg të përmirësor një prezantim, dhe kishte rënë dakord të planifikoj festën e zyrës para pushimeve. Kur kishte ardhur koha për rishqyrtimin e saj për pozitën e partneres, rezultati i saj i qartë si lojtare skuadre, e kombinuar me performancën e saj të shkëlqyeshme, duhet ta kishte bërë atë një fituese. Në vend të kësaj, promovimi i saj u vonua për gjashtë muaj, dhe më pas një vit.

Ky është realiteti i hidhur në shumë vende të punës anembanë botës: gratë ndihmojnë më shumë, por përfitojnë më pak. Në linjë me stereotipet gjinore të rrënjësura thellë, ne presim që burrat të jenë ambiciozë dhe të orientuar drejt rezultateve, dhe gratë të jenë të kujdesshme dhe të shoqërueshme. Kur një burrë ofron ndihmë, ne e lavdërojmë dhe e shpërblejmë. Por, kur një grua ndihmon ne ndihemi më pak borxhli. Është e shoqërueshme apo jo? Dëshiron të jetë pjesë e ekipit? Edhe e kundërta është e vërtetë. Kur një grua refuzon t'i ndihmojë një kolegu, njerëzit e pëlqejnë më pak dhe karriera e saj do të vuaj. Por, kur një burrë thotë jo, ai nuk përballet me reagime. Një burrë që nuk ndihmon është i “zënë” ndërsa një grua është “egoiste”.

Në një studim të udhëhequr nga psikologjia e Universitetit të Nju Jorkut, Madeline Heilman, pjesëmarrësit vlerësuan performancën e një punonjësi, burrë ose grua, që qëndroi ose nuk qëndroi vonë për të ndihmuar kolegët të përgatiteshin për një takim të rëndësishëm. Për qëndrimin vonë dhe për të ndihmuar, një burrë u vlerësua 14 për qind më favorshëm se një grua. Kur të dyja palët refuzuan, një grua u

vlerësua 12 për qind më pak se një burrë. Pas dhënies së ndihmës identike, një burrë kishte shumë më shumë gjasa të rekomandohej për ngritje në detyrë, projekte të rëndësishme, ngritje të pagës dhe shpërblime. Një grua duhej të ndihmonte vetëm për të marrë të njëjtin vlerësim si një burrë që nuk ndihmoi.

Jo shumë kohë më parë, një drejtuese e lartë grua që ne e njohim, ishte ulur në një mbledhje bordi pranë disa kolegëve të rinj meshkuj, kur kryetari i bordit i kërkoi asaj t'i sillte një pije.

Profesorja e Harvardit, Rosabeth Moss Kanter, vërejtë se gratë bëjnë pjesën më të madhe të "punëve të shtëpisë në zyrë" - detyra administrative që ndihmojnë, por nuk paguhen.

Dikush duhet të mbajë shënime, të shërbejë në komitete dhe të planifikojë mbledhje – dhe ashtu njëjtë, siç ndodh me punët e shtëpisë në shtëpi, dikush është zakonisht një grua.

Joan C. Williams, një profesore në Kolegjin Juridik të Hastings të Universitetit të Kalifornisë, zbulon se gratë profesioniste në biznes, dretësi, dhe shkencë ende pritët të sjellin biskota, t'u përgjigjen telefonatave dhe të mbajnë shënime. Këto aktivitete nuk humbin vetëm kohë të vlefshme; ato gjithashtu bëjnë që gratë të humbasin mundësitë. Personi që mban shënime me kujdes në takim, pothuajse kurrë nuk e thotë vendimin e fundit.

Kur burrat ndihmojnë, ata kanë më shumë gjasa ta bëjnë këtë në publik, ndërsa gratë ndihmojnë më shumë në prapaskenë. Studimet tregojnë se burrat kanë më shumë gjasa të kontribuojnë me sjellje të dukshme – si paraqitja në takime universitare – ndërsa gratë angazhohen më privatisht në aktivitete që kërkojnë kohë, si ndihmimi i të tjerëve dhe mentorimi i kolegëve. Siç vuri në dukje profesori i menaxhimit të Kolegjit Simmons, Joyce K. Fletcher, kontributet shoqërore të grave përen thjesht të "zhduken".

Të kesh ndihmën e njerëzve, si në prapaskenë ashtu edhe në publik, është thelbësore për sukses organizativ. Hulumtimet tregojnë se ekipet me sjellje më të madhe ndihmëse arrijnë fitime, shitje, cilësi, efektivitet, të ardhura dhe kënaqësi më të madhe të klientit. Por të bësh punë të stërngarkuar mund të ketë një çmim psikologjik. Në një analizë të 183 studimeve të ndryshme që përfshinin 15 vende dhe dhjetëra profesione, gratë kishin shumë më shumë gjasa të ndiheshin të rraskapitura emocionalisht. Në përpjekjen e tyre për t'u kujdesur për të tjerët, gratë shpesh sakrifikojnë veten. Për çdo 1000 njerëz në punë, 80 gra më shumë se burra digjen - kryesisht sepse nuk arrijnë të sigurojnë maskat e tyre të oksigjenit përpara se të ndihmojnë të tjerët. Ashtu siç duhet të ribalancojmë punët e shtëpisë dhe kujdesin ndaj fëmijëve në shtëpi, ne gjithashtu duhet të barazojmë dhe vlerësojmë punët e shtëpisë në zyrë. Kjo do të thotë fillimisht të pranosh çekuilibrin dhe më pas ta korrigjosh atë.

Shumica e organizatave bëjnë vlerësimin e rregullt të arritjeve individuale. Pse të mos evidentoni edhe aktet e ndihmës? Caktimi i detyrave të përbashkëta në mënyrë të barabartë, në vend që të varen nga vullnetarët, mund të sigurojë gjithashtu që puna mbështetëse të ndahet, vërehet dhe vlerësohet.

Për gratë, ndryshimi më i rëndësishëm fillon me një ndryshim në mentalitet: Nëse duam të kujdesemi për të tjerët, duhet të kujdesemi edhe për veten. Një nga kolegët tanë, Adam, ka kryer dhe rishikuar studime të shumta, që tregojnë se gratë (dhe burrat), arrijnë performancën më të lartë dhe përjetojnë rraskapitje më të ulët, kur i japin përparësi nevojave të tyre së bashku me nevojat e të tjerëve. Duke vënë shqetësimin për veten në të njëjtin nivel me shqetësimin për të tjerët, gratë mund të ndihen më pak altruiste, por ato janë në gjendje të fitojnë më shumë ndikim dhe të mbajnë më shumë energji.

Në fund të fundit, ato mund të japin më shumë.

Në firmën e konsulencës, menaxherja grua që u transferua pas promovimit në detyrë gjeti mënyra më efikase për të ndihmuar. Në vend që të takohej një me një me dhjetëra kolegë të rinj, ajo filloi të ftonte të mentoruarit për dreka në grup. Kjo kurseu kohën e saj dhe krijoi një rrjet mbështetës për ta për të ndihmuar njëri-tjetrin. Në vend që t'i kushtonte shumë kohë telefonatave me pyetje të shumta, ajo shkroi një manual me Pyetjet më të Shpeshta dhe e ndau atë me kolegët. Dhe kur klientët bënin kërkesa të paarsyeshme, në vend që të thoshte se ishte shumë e zënë, ajo shpjegonte se kjo do ta shtynte ekipin e saj të kalonte në pikën e thyerjes. Duke shpjeguar se po mbronte të tjerët, ajo ishte në gjendje të thoshte jo, por ende dukej se po jepte dhe kujdesej. Pasi bëri këto ndryshime, ajo u promovua në pozitën e partneres.

Burrat mund të ndihmojnë në zgjidhjen e këtij problemi duke ngritur zërin. Në artikullin tonë të mëparshëm, kemi vërejtur se burrat e kanë zakon të dominojnë takimet dhe të ndërpresin gratë duke folur. Në vend që të mos flasin, burrat mund të përdorin zërin e tyre për të tërhequr vëmendjen te kontributet e grave. Burrat gjithashtu mund t'i ndihmojnë kësaj çështje duke bërë pjesën e tyre të punës së kujdesit dhe këshillimit. Në një ngjarje të fundit që morëm pjesë, 30 shefa ekzekutivë u mbledhën rreth një tavoline darke për një bisedë rreth mbylljes së hendekut gjinor. Me një përzierje të barabartë të burrave dhe grave në dhomë, ne prisnim që punët e shtëpisë së zyrës t'i binin një gruaje. Por i vetmi person që mbajti shënime gjatë gjithë kohës ishte themeluesi i Virgin Group, Richard Branson.

“Duke u munduar të bësh mirë gjen keq”. Nuk duhet të jetë kështu. Të gjithë ne mund të përfitojmë duke inkurajuar si burrat, ashtu edhe gratë për të ndihmuar, dhe t'i shpërblejmë në mënyrë të barabartë kur e bëjnë këtë.

Ky artikulli është shkruar nga Adam Grant dhe Sheryl Sandberg.

Përkthyer në shqip nga Bardha Nikoliqi.

Skanoji kodin më poshtë për të lexuar artikullin original në gjuhën angleze.



Kur Jia – një konsulente me bazë në Manhattan, lexoi librin më të shitur të Sheryl Sandberg Lean In në 2014, ajo vendosi të ndiqte këshillat e paraqitura në të.

“Unë sapo kisha mbaruar një shkollë biznesi në Ivy League, isha shumë ambicioze dhe më pëlqente ideja e prezantimit tim në karrierën time”, thotë Jia, mbiemri i së cilës po fshihet për të mbrojtur reputacionin e saj profesional. “Mësimi i vetë-promovimit tingëllonte shumë fuqizues dhe isha 100% gati për të vërtetuar se isha gruaja që mund t’i kisha të gjitha: të isha një grua me karrierë të fuqishme dhe një nënë e shkëlqyer”, shtoi ajo.

Por sot, 38-vjeçarja flet me një ton tjetër. Për vite me radhë, ajo thotë se ndihet sikur është anashkaluar për avancimet dhe rritjen e pagave në punë për shkak të gjinisë së saj, veçanërisht pasi u bë nënë në vitin 2018. Që atëherë, ajo ka marrë pjesën më të madhe të përgjegjësive të kujdesit për fëmijët sepse burri i saj, i cili është një bankier, ka rastisur të udhëtojë më shpesh për punë. Kjo, shton ajo, i ka dhënë asaj një reputacion të gabuar në mesin e kolegëve dhe menaxherëve të saj – shumica e të cilëve janë burra – për shkak se dukej sikur nuk kishte ambicie profesionale.

Pastaj kur goditi Covid-19, ishte sikur të gjithë faktorët që tashmë e pengonin atë u dyfishuan. Kur kujdesi ditor i vajzës së saj u mbyll në mars të vitit 2020, Jia u bë automatikisht kujdestare, ndërsa përpiqej të qëndronte në rrjedha të punës. “Isha jashtëzakonisht e pamotivuar sepse ndjeva se po kaloja të gjitha orët e ditës duke u përpjekur të mos rrezohem nga një shirit vrapi, i cili përshpejtohej secilin moment. Por në të njëjtën kohë, ndjeva se po më besohej gjithnjë e më pak për të qenë në gjendje të bëja një punë të mirë. Unë ndieja që karriera ime po më kalonte para syve dhe nuk mund të bëja asgjë për ta ndaluar këtë”, shpjegon ajo.

Në fillim të vitit 2021, terapistja e Jia i tha asaj se vuante nga rraskapitja. Jia thotë se ajo kurrë më parë nuk kishte pasur vështirësi me shëndetin e saj mendor. “Por tani, unë thjesht po përpiqem ta kaloj javën dhe njëkohësisht të ruaj arsyen”, thotë ajo.

Historia e Jia është simptomatike e një çekuilibri të rrënjosur thellë në shoqëri, të cilin pandemia e ka theksuar dhe përkeqësuar. Për arsye të shumta, gratë, veçanërisht nënat, më shumë se burrat kanë gjasa të menaxhojnë një grup përgjegjësish më komplekse në baza ditore – një kombinim shpesh i paparashikueshëm i punëve të shtëpisë të papaguara dhe punës profesionale të paguar.

Megjithëse forca mendore e kërkuar për zotërimin e këtij akti balancues ka qenë e dukshme për dekada, Covid-19 ka zbuluar një aspekt të vrazhdë mbi këtë problem. Statistikat tregojnë se stresi dhe lodhja po prekin më shumë gratë sesa burrat, dhe veçanërisht më shumë nënat që punojnë sesa baballarët. Kjo mund të ketë ndikime të shumta në botën e punës pas pandemisë, duke e bërë të rëndësishme që shoqëria të gjejë mënyra për të zvogëluar këtë çekuilibër.

Kërkesa të pabarabarta

Të dhënat e fundit që trajtojnë posaçërisht rraskapitjen e grave janë shqetësuese. Sipas një sondazhi nga LinkedIn, nga gati 5,000 amerikanë, 74% e grave thanë se ishin shumë ose disi të stresuara për arsye të lidhura me punën, krahasuar me vetëm 61% të të anketuarëve burra.

Një analizë tjetër nga konsulenca A Great Place to Work zbuloi se nënat në punë me pagesë kanë 23% më shumë gjasa të përjetojnë rraskapitje sesa baballarët. Rreth 2.35 milion nëna që punojnë në SHBA kanë vuajtur nga rraskapitja që nga fillimi i pandemisë, veça-

-nërisht për shkak të kërkesave të pabarabarta të shtëpisë dhe punës. Ekspertët në përgjithësi pajtohen se nuk ka një arsye të vetme që gratë të rraskapiten, por ata e pranojnë gjerësisht se mënyra e ndërthurjes së strukturave shoqërore dhe normave gjinore luan një rol të rëndësishëm. Pabarazitë në vendin e punës, për shembull, janë të lidhura pazgjidhshmërisht me rolet tradicionale gjinore.

Në SHBA, gratë ende fitojnë një mesatare prej rreth 82 cent për çdo dollar të fituar nga një burrë, dhe hendeku në shumë vende në Evropë është i ngjashëm. Firma e Jia-s nuk publikon të dhënat për hendekun gjinor të pagave, por ajo beson se ky hendek është i konsiderueshëm. Për më tepër, ajo mendon se shumë nga bashkëmoshatarët e saj burra fitojnë më shumë se ajo, diçka që i shkakton asaj stres.

“Ideja që mund të paguhem më pak është jashtëzakonisht zhgënjyese, por gjithashtu nuk dua të bëhem e padurueshme, duke kërkuar më shumë para, kur unë tashmë po i tejkaloj kufijtë duke i kërkuar kompanisë sime të ma përshtatë orarin, në mënyrë që të kujdesem për vajzën time. Është një betejë e brendshme e vazhdueshme”, thotë ajo.

Hulumtimi bën lidhje në mes të të ardhurave më të ulëta me nivelet më të larta të stresit dhe shëndetit më të keq mendor në përgjithësi. Por disa studime kanë treguar gjithashtu më konkretisht, se rastet e rraskapitjes tek gratë janë më të mëdha, për shkak të dallimeve në kushtet e punës dhe ndikimit të gjinisë në progres.

Në vitin 2018, studiuesit nga Universiteti i Montrealit publikuan një studim që gjurmonte 2,026 punonjës gjatë katër viteve. Akademikët arritën në përfundimin se gratë ishin më të prekura nga rraskapitja sesa burrat, sepse gratë kishin më pak gjasa të promovoheshin sesa burrat, dhe për këtë arsye kishin më shumë gjasa të ishin në pozita me më pak autoritet, gjë që mund të çojë në rritjen e stresit dhe zhgënjimit. Studiuesit gjithashtu zbuluan se gratë kishin më shumë

gjasa të kryesonin familje me një prind, të përjetonin probleme të lidhura me fëmijët, të investonin kohë në detyrat e shtëpisë dhe të kishin vetëbesim më të ulët – të gjithë këto faktorë që mund të përkeqësojnë rraskapitjen.

Nancy Beauregard, një profesore në Universitetin e Montrealit dhe një nga autoret e studimit, tha se duke reflektuar mbi punën e saj në vitin 2018, është e qartë se Covid-19 ka përforcuar pabarazitë dhe mosbalancimet ekzistuese që ekipi i saj demonstroi përmes hulumtimit të tyre. “Për sa i përket zhvillimit të qëndrueshëm të kapitalit njerëzor të fuqisë punëtore, ne nuk po shkojmë në një drejtim të mirë”, shtoi ajo.

Një katalizator pandemik

Brian Kropp, shefi i hulumtimeve për burime njerëzore në Gartner, një firmë kërkimore dhe këshilluese globale me seli në Connecticut, SHBA, pajtohet se, përderisa shumë nga faktorët që nxisin rraskapitjen e grave ishin në lojë para pandemisë, Covid-19 veçanërisht i përkeqësoi disa prej tyre, pasi na detyroi të rishikojmë në mënyrë dramatike rutinat tona të jetesës dhe punës.

Strukturat që mbështesin jetën e prindërve dhe kujdestarëve u mbyllën, dhe në shumicën e rasteve, kjo barrë e tepërt ra mbi gratë. Një studim i kryer nga Universiteti i Harvardit vlerësoi përgjigjet e sondazhit nga 30,000 individë në të gjithë botën dhe zbuloi se gratë – veçanërisht nënat – kishin kaluar shumë më tepër kohë në punët e shtëpisë dhe kujdesin e fëmijëve gjatë Covid-19 sesa para pandemisë, dhe se kjo ishte e lidhur drejtpërdrejt me mirëqenie më të ulët. Shumë gra tashmë ishin vendosur si kujdestare të paracaktuara brenda familjeve të tyre, dhe pandemia fshiu sistemet mbështetëse që më parë

i kishin lejuar të balanconin punën e paguar dhe punën në shtëpi. Kjo është pikërisht ajo që Sara përjetoi në mars të vitit 2020, kur shkollat në të gjithë Nju Jorkun u mbyllën për herë të parë. “Fillimisht, mesazhi ishte se shkollat do të qëndronin të mbyllura deri në fund të prillit, kështu që ky ishte objektivi im: “Të mbërrij në atë pikë dhe pastaj gjithçka do jetë mirë”,” thotë 40-vjeçarja. Tani, më shumë se 18 muaj në pandemi, dy djemtë e saj, të moshës 6 dhe 9 vjeç, sapo po njoftohen me mësimin fizik dhe jeta e Sarës ka ndryshuar në mënyrë dramatike.

Në prill të vitit 2020, për herë të parë ajo filloi të vuante nga ankthi. Presionet e shkollimit të fëmijëve të saj në shtëpi, përderisa punonte si drejtuese marketingu për një kompani të madhe teknologjike, e pushtuan atë. Ajo nuk mund të flinte, shqetësohej vazhdimisht dhe ndihej në depresion. Më e keqja nga të gjitha, është se ajo ndjehej sikur çdo gjë që bënte, ishte joadekuate, sepse nuk kishte kohë të mjaftueshme për të bërë asgjë siç duhej.

Gjashtë muaj pas pandemisë, ishte e qartë se diçka duhej të ndryshonte. Burri i Sarës, një avokat, po fitonte shumë më tepër se ajo, dhe kjo kishte ndodhur që kur u martuan në vitin 2008. Kështu, në gusht të vitit 2020, çifti së bashku vendosën që Sara do të linte punën e saj, për t’u bërë nënë dhe të qëndronte në shtëpi. “Para kësaj, kurrë nuk e dija vërtet se çfarë do të thoshte të rraskapitesh. Tani e di sigurt, pa asnjë fije dyshimi”, tha ajo.

Përvoja e Sarës është simbolizim i një tendence shumë më të gjerë. Në shtator të vitit të kaluar, pikërisht kur pandemia po merrte ritmin, më shumë se 860,000 gra u larguan nga fuqia punëtore amerikane, krahasuar me pak më shumë se 200,000 burra. Një studim zbuloi se numri i nënave që kishin lënë fuqinë punëtore amerikane midis shkurtit dhe shtatorit të vitit të kaluar ishte 900,000 dhe numri i baba-

-llarëve ishte 300,000.

Përderisa gratë humbën jetën shoqërore gjatë izolimit – faktor i cili mund të kenë qenë mjet emocional dhe fizik për shkaktimin e stresit – është e qartë se orteku i papritur i përgjegjësive shtëpiake shtesë i lodhi shumë ato gra, që tashmë po merreshin me punë në shtëpi dhe me punë profesionale.

Me çfarë kostoje?

Një nga shqetësimet më të mëdha të ekspertëve, është se shëndeti i dobët mendor tek gratë në vendin e punës, mund të dekurajojë brezat e ardhshëm për vendosjen e synimeve ambicioze profesionale, veçanërisht nëse duan të krijojnë një familje. Kjo mund të përkeqësojë pabarazitë gjinore që tashmë ekzistojnë, për sa i përket pagës dhe moshës në tregun e punës.

Të dhënat tregojnë se ky është me të vërtetë një shqetësim legjitim; statistikat e mbledhura nga CNBC dhe kompania e sondazheve SurveyMonkey në fillim të këtij viti, treguan se numri i grave që e përshkruajnë veten si “shumë ambicioze” në aspektin e karrierës së tyre ka rënë ndjeshëm gjatë pandemisë. Të dhënat nga Byroja e Regjistrimit të SHBA tregojnë se gjatë 12 javëve të para të pandemisë, përqindja e nënave midis moshës 25 dhe 44 vjeç që nuk punojnë për shkak të çështjeve të kujdesit ndaj fëmijëve të lidhura me Covid-19, u rrit me 4.8% krahasuar me asnjë rritje për burrat në të njëjtën grupmoshë.

Po kështu, ka shqetësime se si mënyrat e reja të punës, si ato hibride, mund të ndikojnë në barazinë gjinore në vendin e punës. Hulumtimet tregojnë se gratë, më shumë se burrat, kanë të ngjarë të punojnë nga shtëpia në një botë pas pandemisë, por ka dëshmi se

njerëzit që punojnë nga shtëpia kanë më pak gjasa të promovohen, sesa ata që kanë më shumë takime me menaxherët. “Gratë po thonë se po punojnë po aq shumë dhe po bëjnë po aq shumë sa të tjerët, por për shkak se po punojnë nga shtëpia, kanë më pak të ngjarë të promovohen. Kjo është jashtëzakonisht demotivuese”, thotë Kropp.

Dean Nicholson, kryesuesi i terapisë për të rritur në klinikën e sjelljes në Londër The Soke, sugjeron që perceptimet për barazinë mund të ndikojnë në pjesëmarrjen e grave në vendin e punës. “Kur ekuilibri i drejtësisë është i prishur kundër nesh në vendin e punës, atëherë ai gjithmonë do të çojë në ndjenja negative, jo vetëm ndaj organizatës, por në mënyrën se si ndihemi për veten dhe vlerën e kontributit tonë, si dhe ku ne jemi të pozicionuar në një hierarki vlerash”, thotë ai.

“Për të parandaluar një eksod të talenteve gra, organizatat duhet të vlerësojnë që praktikatat e vjetra të vendeve të punës nuk janë më të përshtatshme. Menaxherët duhet të rimendojnë rrënjësisht se si kompanitë duhet të strukturohen, në mënyrë që të promovojnë drejtësinë dhe barazinë e mundësive. Kjo do të thotë të krijosh barazi dhe mundësi të barabarta për promovim, si dhe krijimin e një kulture transparence ku të gjithë – nënat, baballarët dhe punonjësit që nuk janë prindër – ndihen të vlerësuar dhe mund të arrijnë potencialin e tyre profesional, duke akomoduar gjithashtu ato që po ndodhin në shtëpi”, shton Kropp.

Steve Hatfield, kryesuesi i së Ardhmes Globale të Punës për Deloitte, vëren se nënat, veçanërisht ato në role udhëheqëse të larta, janë modele jashtëzakonisht të rëndësishme. “Efekti i valëzuar i asaj që ato shihet se po përjetojnë tani, ka potencialin të jetë vërtet i thellë për punonjëset më të reja, dhe kështu u takon organizatave të vërtetojnë, se ato mund të përshtaten dhe të plotësojnë nevojat e të gjithë punonjësve”, thotë ai.

Hephzi Pemberton, themeluese e Grupit të Barazisë, një konsulencë me qendër në Londër që fokusohet në përfshirjen dhe diversitetin në industrinë e financave dhe teknologjisë, thekson nevojën që menaxherët të trajnohen zyrtarisht dhe të kuptojnë se iniciativa për të krijuar një vend pune të përshtatshëm, duhet të vijë nga punëdhënësi dhe jo nga punëmarrësi. “Kjo është absolutisht kritike për të shmangur rrezikun e rraskapitjes”, thotë ajo.

Por Jia, e cila thotë se tani është në prag të lënies së punës, këmbëngul se ndryshime të dukshme duhet të ndodhin në shtëpi, si dhe në vendin e punës. “Ajo që është bërë shumë e qartë për mua, përmes pandemisë, është se ne të gjithë kemi një rol për të luajtur në kuptimin e çekuilibrave që krijohen kur rolet stereotipike gjinore respektohen verbërisht. Po, sigurisht që ndonjëherë ka kuptim që një grua të jetë kujdestarja e paracaktuar, ose të bëjë një hap prapa nga puna e paguar, por ne duhet të vlerësojmë me çfarë kostoje ta bëjmë këtë. Ky është viti 2021. Ndonjëherë pyes veten nëse jemi në vitet 1950”, thotë ajo.

Ky artikulli është shkruar nga Josie Cox.

Përkthyer në shqip nga Riola Morina.

Skroni kodin më poshtë për të lexuar artikullin original në gjuhën angleze.





NUK ËSHTE

PUNË

DASHURIE

Në këtë intervistë, të publikuar në revistën Public Seminar, në Mars 2022, studiuesja dhe aktivistja Silvia Federici diskuton fushatën “Pagë për punë të shtëpisë”, e cila u shfaq në vitet 1970-ta si një kritikë radikale e dinamikës së punës kapitaliste, duke theksuar se puna në shtëpi është qendrore për prodhimin e fuqisë punëtore të kapitalizmit. Federici reflekton mbi ndikimin e fushatës në mendimin feminist, duke zbuluar se si ajo sfidoi nocionet tradicionale të punës dhe vlerës ekonomike, duke theksuar rëndësinë e punëve të papaguara të shtëpisë. Ajo gjithashtu i lidh këto njohuri me problematikat aktuale, duke përfshirë përkeqësimin e pabarazive nga pandemia dhe implikimet më të gjera të eksploatimit kapitalist dhe pabarazitë e kujdesit shëndetësor.

Catrin Ashton: Për herë të parë hasa në punën tuaj në një moment, që për mua personalisht, ishte ideal: po qëndroja në shtëpi, për disa muaj tashmë, me fëmijë të posalindur, kur rastisa të lexoj esenë e Maria Rosa Dalla Costa dhe Selma James “Fuqia e Grave dhe Përmbysja e Komunitetit.” Ajo që më bëri përshtypje ishte se sa pak kishte ndryshuar brenda 40 viteve. Isha rritur me konceptin e një feminizmi që nuk dukej se vlente më, tashmë që kisha një foshnje. Puna ime përfshinte shumë udhëtime. U detyrova ta lë atë, dhe papritmas, e gjeta vetën në shtëpi pa transport, pa para.

Ishte situatë e çuditshme ku e gjeta vetën, krejt papritmas. Më pas filluam kampanjën në Uells, të inspiruar nga Paga për Punë Shtëpie (Wages for Housework). A mund të jepni një përmbledhje të fillimeve të kampanjës, dhe të shpjegoni inspirimin prapa përfshirjes suaj?

Silvia Federici: Kampanja jonë filloi gjatë viteve të hershme të 1970-ve, me gra nga vende të ndryshme, kryesisht nga Italia dhe disa nga Anglia. Atëkohë isha në SHBA, por vija nga Italia. Kampanja Pagë

për Punë të Shtëpisë ishte një alternativë ndaj strategjive që shumë feministe po organizonin, si rrugë drejt çlirimit të grave. Trendi dominant brenda lëvizjes feministe atëkohë vinte kryesisht nga një traditë majtiste.

Në fakt, kishte dy trende: një nga feministet radikale, të cilat identifikonin patriarkalizmin si shkaktar prapa sistemit shtypës të grave, por asnjëherë nuk definojnë qartësisht se si kishte evoluar dominimi mashkullor përgjatë historisë (strategjia e feministëve radikale ishte zakonisht për të krijuar hapësira kulturore, të cilat do të ishin kryesisht hapësira të grave); pastaj kishim feministet socialiste/feministet marksiste, të cilat na thonin se rruga drejt çlirimit ishte marrja e punëve me pagë dhe bashkimi me klasën punëtore, dhe që problemi me gratë – të diskriminuara në bazë të gjinisë – rrjedhte nga kufizimi i grave në punë shtëpie.

Argumenti ishte që puna e shtëpisë nuk prodhon kurrfarë pasurie sociale, që është aktivitet prapambetës, dhe që në fakt nuk është pjesë e organizimit kapitalist të punës, dhe kështu, gratë të cilat janë të përfshira kryesisht me këtë lloj pune, nuk kanë fuqinë për të ndryshuar shoqërinë.

Burrat, për shembull, mund të ndërprejnë punën e tyre. Ata mund të shkojnë në grevë për shkak se ata prodhojnë kapital, dhe kështu mund të ndërpresin rrjedhën e kapitalit. Kështu, argumenti, të cilin e gjeni në Marks dhe Engels dhe në gjithë traditën komuniste Marksiste, ishte se çlirimi i grave nënkupton daljen, anëtarësimin në një sindikatë, dhe kështu me radhë. Por unë vija nga një grup i feministëve të cilat filluan të analizojnë kushtet e punës së grave – të punës së shtëpisë – dhe arritëm në një konkluzion tërësisht të ndryshëm.

Ne konkluduar se puna e shtëpisë është një pjesë jashtëzakonisht e

rëndësishme e organizimit kapitalist të punës. Ajo që “prodhohet” përmes punës së shtëpisë janë vetë punëtorët.

Me fjalë të tjera, organizimi kapitalist i punës, siç përshkruhet nga tradita majtiste, ishte një organizim shumë i pjesshëm, sepse ai njihje vetëm prodhimin dhe prodhimin nga puna me pagë, prodhimin industrial dhe punën në zyrë. Ai njihje vetëm punën me pagë dhe prodhimin e mallrave. Asnjëherë nuk e njohu tërësinë e organizimit prapa prodhimit dhe punëtorit/es – prodhimin e kapacitetit për punë. Pra, për ne, Kampanja Pagë për Punë të Shtëpisë kishte shumë kuptime.

Pikë së pari, ajo e bëri të dukshme që kjo punë nuk është vetëm një aktivitet i natyrshëm, diçka që gratë bëjnë sepse janë gra. Nuk është mbetje e shoqërisë para-kapitaliste, por punë që është qendrore për çdo aktivitet, për çdo aktivitet ekonomik.

Edhe pse nuk ishte qëllimi i vetëm i kampanjës, thirrja që dëshironim pagë për punë shtëpie – sistemi mbështetës, shtylla e çdo aktiviteti ekonomik – sepse po punonim për punëdhënësit e njëjtë për të cilët punonin punëtorët me pagë, ishte qendrore. Ishte strategji epistemike për t’a bërë të dukshme atë që deri atëherë kishte mbetur e padukshme.

Catrin Ashton: Ishte ky aspekt i kampanjës që për mua ishte shumë emocionues. Ai radikalizoi të qenit nënë apo të qëndruarit në shtëpi. I dhatë një lloj fuqie asaj pozitive, dhe kështu u bë e mundur të flisje rreth ndryshimit të shoqërisë nga aty, në vend se të detyrohesh të lëshoje shtëpinë.

Silvia Federici: Po, sepse në traditën majtiste, në Partinë Komuniste dhe në organizimin e grave në të majtën, ato bëheshin punëtoreshë kur shkonin në fabrikë, apo kur shkonin të punonin jashtë shtëpisë. Përndryshe, ato nuk konsideroheshin punëtoreshë, dhe kjo është shumë

e rëndësishme të thuhet, sepse kjo nënkuptonte që ky organizim jo vetëm që asnjëherë nuk njihnte punën që gratë bënin, por edhe funksionin e punës së shtëpisë në prodhimin e fuqisë punëtore. Ato kurrë nuk e panë shtëpinë si një vend i betejës. Beteja ishte për punë me pagë.

Ato nuk kuptuan diçka të thellë rreth organizimit kapitalist të punës, rreth akumulimit kapitalist si tërësi: duke mos parë punën e papaguar që gratë bëjnë, duke mos kuptuar që e gjithë klasa kapitaliste, secili punëdhënës që ka eksploatuar atë punë, ka përfituar duke e natyralizuar atë, duke e bërë të duket si ‘punë e qejfit’ dhe duke mos e njohur atë si punë.

Duke injoruar të gjithë këtë, jo vetëm që kanë përqaftuar dhe legjitimuar këndvështrimin kapitalist, por edhe kanë prezantuar një imazh të shtrembëruar të akumulimit kapitalist. Akumulimi kapitalist, në pikëpamjen e tyre, ndodh në fabrikë, në zyrë, dhe përmes punës me pagë.

Ato nuk e shihnin që paga organizon punën e komunitetit, organizon punën që ndodh në shtëpi, dhe që me këto paga, punëdhënësit punësojnë jo vetëm një punëtor/e, por më shumë se një punëtor/e: ata gjithashtu punësojnë njerëzit të cilët riprodhojnë ata, të cilët riprodhojnë kapacitetin e tyre për punë.

Ne kuptuam që akumulimi kapitalist varet nga një sasi e jashtëzakonshme e punës së papaguar, e cila është shumë më e gjerë se ajo që tradita Marksiste socialiste kishte pranuar dhe njohur ndonjëherë. Ne gjithashtu pamë lidhjen mes seksizmit dhe racizmit. Kapitalizmi me pagë ka krijuar një hierarki të punës me punëtorët e paguar në krye: kryesisht të bardhë, kryesisht meshkuj. Punëtorët e papaguara – gratë, punëtorët e shtëpisë, dhe subjektet koloniale, natyrisht në fund. Skllëverit dhe skllavëria kanë pasur ndikim të

jashtëzakonshëm në akumulim të kapitalit. Kur shikojmë diskriminimin e grave nga këndvështrimi i riprodhimit, shohim një perspektivë të ndryshme për kapitalizmin si tërësi.

Catrin Ashton: Lidhja që ju bëni mes punës që një grua bën privatisht në shtëpinë e saj dhe gjithë punën e papaguar të bërë kudo, globalisht dhe historikisht, të cilën ju e përshkruani si qendrore për kapitalizmin, është posaçërisht inspiruese.

Silvia Federici: Momentin kur kuptuam rëndësinë e asaj që puna riprodhuese, atë që puna e shtëpisë përfaqëson në punë, në procesin e akumulimit, atëherë filluam të kuptojmë edhe rolin e pagës. Ne pamë që paga nuk është kompensim pune për një punë të bërë, apo edhe si një mënyrë e nxjerrjes së një pune të papaguar nga dita e punës së punëtorit me pagë. Përkundrazi, paga është një mënyrë e tërë e organizimit të shoqërisë. Ajo është gjithashtu mënyrë e fshehjes së fushave të tëra të eksploatimit duke përshkruar vetëm disa punëtorë të caktuar – vetëm punëtorët me pagë – si punëtorë.

Kjo natyralizon dhe fsheh fusha të tëra të eksploatimit. Ne e dimë që Marksi, për shembull, si abolicionist, i kishte shkruar Lincoln-it gjatë Luftës Civile Amerikane rreth kampanjës së parë ndërkombëtare për të bojkotuar tregtinë e pambukut, për shkak të shfrytëzimit të punës së skllëvërve, edhe duke uruar atë për deklaratën e emancipimit, por edhe duke kritikuar atë për mos-analizimin në fakt të punës së skllëvërve si prodhues të akumulimit kapitalist, në tri vëllime të tëra.

Ka pasazhe aty këtu, por për Marks, terreni themelor i betejës – puna industriale – ishte e nën-përfaqësuar. Marksi e shihte skllavërinë në të njëjtën mënyrë siç e shihte punën e shtëpisë – si një lloj aktiviteti që do të mbetej prapa, si një gjë që është historikisht e prapambetur, e cila do të tejkalohet përmes një zhvillimi të ardhshëm kapitalist.

Por ne kemi parë që kjo nuk ka qenë e vërtetë aspak. Heqja e

skllavërisë ka qenë më shumë formale sesa reale. Ne kemi parë, për shembull, që përmes procesit të globalizimit, ekspansioni botëror i kapitalit, nga vitet 1970 më së paku, ka çuar drejt një ekspansioni të punës informale. Kjo ka shpjer në zgjerim të të gjitha llojeve të aktiviteteve të papaguara, të aktiviteteve informale që janë jashtë relacionit të pagës. Kështu, kur ne folëm për punët e shtëpisë, këtë e interpretojmë si një prizëmë, si një dritare për të parë sistemin kapitalist, që ishte shumë e rëndësishme për mua.

Mendoj që puna që kemi bërë në vitet 1970-ta duke analizuar punët e shtëpisë, duke analizuar pagën – ishte fundamentale për deshifrimin, interpretimin, dhe analizimin e të gjithë procesit të rikolonizimit që ndodhi gjatë viteve 1980 dhe 1990 dhe ende vazhdon të ndodhë përgjatë Amerikës Latine, Afrikës, e ndikuar nga puna e FMN-së, përshtatjeve strukturore, privatizimit, etj. Kjo më ndihmoi jashtëzakonisht shumë me punën që kishim bërë, sepse kuptuam rëndësinë e kapitalizmit në relacion me punën e papaguar dhe me hierarkinë.

Kapitalizmi është prodhues i ndryshimeve. Zhvillimi kapitalist duhet vazhdimisht të zhvillojë hierarki të reja, ndarje të reja. Ai gjithmonë i përgjigjet krizave të veta përmes një procesi masiv të ekspropriimit, një procesi masiv të përjashtimit nga çfarëdo forme e riprodhimit.

Kur Maria Rosa Dalla Costa thotë që amvisja është ikonike- e cila, natyrisht, është një deklaratë që duhet të cilësohet – ka diçka shumë të thellë këtu. Ajo është ikonike si figurë që mishëron punëtoreshën e papaguar. Ajo është edhe ‘punëtoreshja e papaguar’ por edhe ‘punëtoreshja’ e cila nuk njihet si e tillë. Ajo është figurë marginale, e destinuar të anashkalohet nga zhvillimi kapitalist.

Zgjerimi i kapitalizmit vetëm sa ka rritur punën e papaguar. Studentëve në SHBA, Evropë, për shembull, u kërkohet të bëjnë

shumë punë të papaguar, nën pretendimin e fitimit të aftësive dhe përvojës. Ne dimë kompani të cilët nxjerrin njerëz nga puna për shkak që universitetet u dërgojnë atyre praktikantë të papaguar.

Catrin Ashton: Në të njëjtën kohë, përkundër idesë që gratë disi emancipohen nga punët e shtëpisë, për shkak që mund të dalim të punojmë nëse dëshirojmë, por edhe të fitojmë paga të larta në disa raste, pandemia ka treguar që gratë ende bëjnë shumicën e punës në shtëpi.

Pagë për Punë të Shtëpisë ishte një kampanjë për shumë më shumë se vetëm një pagë. Mes gjërash tjera, kampanja bënte thirrje për autonominë e grave mbi trupat e tyre. Kishte një kampanjë pro abortit, kampanja kundër sterilizimit, dhe kampanja kundër medikalizimit të trupave të grave. Thirrja ishte që gratë të jenë në gjendje të kuptojnë trupat e tyre. Kishte gjithashtu një thirrje që shteti të ndalonte, për shembull, kontrollin e trupave të grave për të kontrolluar lindjet.

Në Mbretërinë e Bashkuar, një pjesë e madhe e stafit për kujdes shtëpiak vjen nga Evropa Jugore ose Lindore. Këta janë zakonisht persona që kanë tendencë të jenë dyshuese ndaj vaksinimit kundër COVID-19, por megjithatë, këtu janë, kryesisht gra, në masë të madhe të nën-paguara dhe u kërkohet të bëjnë diçka në trupat e tyre për të cilën janë shumë hezituese ta bëjnë, për të mirën e njerëzve. Ju keni shkruar se si kapitalizmi ka transformuar trupin në një makinë pune, dhe ja këtu është një shembull i makinës së punës që është adaptuar në mënyrë që të funksionoj ‘më mirë’ në një pandemi.

Përveç vënies në pikëpyetje të kohës së vendimeve – nëse reagimet ishin shumë të shpejta apo të ngadalta – nuk mendoj se ne në të majtën kemi kritikuar në mënyrë adekuate përgjigjen e qeverisë së MB-së ndaj pandemisë. A mendoni që, për shkak të natyrës së kësaj

krize, kjo është e drejtë, apo mendoni që, si marksiste, si feministe, si aktiviste të së majtës, ne duhet të bëjmë më shumë pyetje?

Dhe, për t'iu kthyer prapë punëtoreve të kujdesit shtëpiak, si përputhet kjo problematikë aktuale në kontekstin më të gjerë të kontrollit shtetëror mbi trupat e grave të klasës punëtore? A ekziston një pyetje mbi përgjigjet negative që ato marrin nëse nuk i përmbahen këtyre kontrolleve?

Silvia Federici: Po, ka shumë pyetje që duhen bërë. Por me lejon të ofroj pak kontekst së pari.

Kampanja Pagë për Punë të Shtëpisë është marrë edhe me çështjen e abortit. Ne ishim kritike, ashtu siç ishin edhe shumë organizata të grave zezake, për pozitën ekskluzive që lëvizja feministe mbante mbi abortin. Aborti nënkuptonte të drejtën për të zgjedhur, dhe ne thamë, për të zgjedhur, për të kontrolluar kapacitetin tonë riprodhues, ne gjithashtu duhet të luftojmë për të drejtën për të pasur fëmijë.

Në SHBA, grave zezake gjithmonë u janë mohuar të drejtat e lehonisë. Kjo ka qenë e vërtetë që nga koha e skllavërisë e deri tani. Kontrolli mbi trupat tonë ka dy aspekte: ne duam të jemi të lira të vendosim të mos kemi fëmijë, por gjithashtu duam të drejtën të kemi fëmijë. Për të pasur fëmijë, ekziston një betejë për resurset e nevojshme në mënyrë që të mos jemi të varura nga një burrë.

Gjithashtu – dhe kjo është e rëndësishme – ne kemi parë se si përgjatë viteve, gratë të cilat kanë dalur dhe kanë gjetur një punë jashtë shtëpisë, me disa përjashtime, marrin punë të rrezikshme dhe të nënpaguara, pa ndonjë autonomi. Në SHBA, gratë e klasës punëtore kanë sasi të mëdha të borxhit, për shkak që paga asnjëherë nuk është e mjaftueshme: është shumë vështirë të fitohen 15 dollarë amerikan për orë; shumica fitojnë 7 dollarë për orë, dhe me miliona fitojnë vetëm

15,000 dollarë në vit, duke përfshirë emigrantët, të cilët duhet të dërgojnë para edhe në shtëpitë e tyre. Qartësisht, këto nuk janë paga që ofrojnë jetesë, dhe kështu disa njerëz duhet t'u drejtohen kredive. Kjo është mënyra e vetme për të mbijetuar.

Gjatë pandemisë, 5 milionë gra humbën punën e paguar, dhe 2.5 milionë spontanisht lanë punët e tyre sepse kishin fëmijë në shtëpi kur shkollat u mbyllën. Gjendja është dëshpëruese.

Punëtorët e shtëpisë janë në një gjendje të tmerrshme. Së pari, edhe në Evropë edhe në SHBA, ato janë gra emigrante nga Afrika, Ishujt Karaibe, dhe Filipine, të cilat lanë prapa vende të varfëra ose të shkatërruara nga luftërat, nga politikat e FMN-së, kapitalit ndërkombëtar, Bashkimit Evropian, Qeverisë së SHBA-së, dhe kështu me radhë. Më pas, kur filloi pandemia COVID-19, shumë mbetën pa asgjë nga familjet për të cilat punonin. Jo vetëm që ato kanë vuajtur personalisht, por edhe familjet e tyre të cilat i mbështesin. Ndjem që është e padrejtë të detyrohen që të vaksinohen kundër vullnetit të tyre.

Është shumë e vështirë për njerëz si unë që të marrin një pozicion të duhur mbi vaksinimin, për shkak që nuk i dijmë të gjitha detajet. Unë nuk jam mjekë, nuk i kam kualifikimet për të kuptuar të gjitha aspektet e këtyre vaksinave të reja. Por ekzistojnë disa pyetje që duhen theksuar, si për shembull, pse asnjëherë nuk dëgjojmë për terapi apo mënyra të tjera që gjithashtu mund të ndihmojnë?

Nuk i kemi të gjitha informatat se sa njerëz, për shembull, vdesin nga kanceri krahasuar me COVID-19. Sidoqoftë, kanceri ngreh pyetje rreth problematikës më të gjerë të përdorimit të pesticideve, kontaminimit të ujit dhe ajrit, dhe një ambienti që gjithmonë e më shumë është shkatërrues për trupat tonë, posaçërisht në pjesët më së paku të privileguara të botës. Për këtë nuk flitet, që më bënë

jashtëzakonisht dyshuese, që ajo me të cilën kemi të bëjmë, nuk është brenga për shëndetin tonë, por brenga për profitin e korporatave të mëdha.

Vaksinat kundër COVID-19 shiten si zgjidhje universale, si mrekulli. Na thuhet të mos brengosemi për pasojat afatgjata. Por, ne ende nuk e dimë se cilat janë ato. Natyrisht, kjo nuk domethënë që vaksinat kundër COVID-19 nuk janë duke ofruar mbrojtje. Por ajo që na thuhet, është se çkado është më mirë se vdekja, dhe kështu ne e përqafojmë këtë filozofi. Mendoj që ka ende shumë pyetje që kanë mbetur pa përgjigje që lidhen me sistemet shëndetësore, të cilat janë shkatërruar përgjatë viteve.

Vdekshmëria e lartë që COVID-19 ka shkaktuar është një fatkeqësi politike. Një vdekshmëri e tillë mund të jetë shmangur nëse sistemet tona shëndetësore dhe kujdesi ynë për ushqimin të mos ishin gërryer vazhdimisht. Por të ngresh pyetje rreth vaksinave të bënë mbështetëse të Trump dhe fashiste. Më vjen vërtetë keq që, tani kur dalim, gjëja e parë që njerëzit pyesin njëri tjetrin është “a jeni vaksinuar?” Mendoj që diskutimi është më kompleks se kaq.

Pandemia na ofron një moment të së vërtetës. Sistemi të cilin e ndjekim është destruktiv. Ai na vë të gjithëve në rrezik, por disa më shumë se të tjerët: komunitetet zezakë, të moshuarit, njerëzit e ish-botës kolonialiste. Ne kemi parë edhe karakterin e pafytyrë komercial të shumë kompanive farmaceutike. Ato kanë shfrytëzuar paratë publike për kërkimet e tyre, dhe tani detyrojnë të gjithë të paguajnë, dhe shpesh duke kufizuar të drejtën në patente.

Është e qartë që klasa kapitaliste do të përdor COVID-19 ndërkombëtarisht për një ristrukturim madhor të zhvillimit kapitalist. Forumi Ekonomik Ndërkombëtar është duke folur për një rifillim kapitalist: një formë të re të zhvillimit kapitalist, riorganizim të punës,

një rishpërndarje të pasurisë. Dua të di nëse njerëzit të cilët janë të interesuar për një lloj të ndryshëm të shoqërisë, janë po ata të cilët do të organizojnë një rifillim. Për mua pyetja është, se kush saktësisht do të vë themelet për atë që do të vie?

Kjo intervistë me Silvia Federici është zhvilluar nga Catrin Ashton.

Përkthyer në shqip nga Blerton Ajeti.

Skanoji kodin më poshtë për të lexuar artikullin original në gjuhën angleze.



Çdo grua

është grua

punëtore

qika